



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 12

Tiranë – E hënë, 23 janar 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 10.1.2023	Për përcaktimin e programeve të formimit profesional që përfitojnë nga mbështetja financiare, për vitin 2023..... 1661
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 1, datë 5.1.2023	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH..... 1661
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 303, datë 25.11.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike..... 1662
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 304, datë 25.11.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “Erni Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën Bilisht, qarku Korçë..... 1663
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 323, datë 14.12.2022	Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 242, datë 23.9.2022, të Bordit të ERE-s, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë, për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”, të ndryshuar..... 1664
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 324, datë 14.12.2022	Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022” 1666
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 325, datë 14.12.2022	Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, “Mbi vlerësimet e ERE-s për kostot e aktivitetit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, për periudhën 1.5.2022–31.12.2022” 1668

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 326, datë 14.12.2022	Mbi lënien në fuqi të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2023.....	1669
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 327, datë 14.12.2022	Mbi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, për vitin 2023.....	1670
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 329, datë 14.12.2022	Mbi një ndryshim në vendimin nr. 247, datë 29.9.2022, për licencimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.....	1672
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 331, datë 19.12.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “H&E Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	1673
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 332, datë 19.12.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “Bigwind” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier.....	1674
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 333, datë 19.12.2022	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Ateani Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Shutri 1”, me kapacitet të instaluar 370 kw, dhe “Shutri 2”, me kapacitet 1600 kw, me kapacitet total të instaluar 1970 kw.....	1675
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 334, datë 19.12.2022	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Ateani Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	1677
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 335, datë 19.12.2022	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 24.5.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Irarba Energji’ sh.p.k për transferimin e asetëve të paluajtshme, në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.”.....	1679
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 339, datë 21.12.2022	Për një ndryshim në vendimin e ERE-s nr. 28, datë 14.2.2022, mbi kërkesën e OSSH sh.a., për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, ‘Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, dhe nr. 146, datë 24.12.2013”.....	1680
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 340, datë 21.12.2022	Mbi rinovimin e licencës nr. 395, seria F18, të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	1682
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 341, datë 21.12.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	1683
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 342, datë 21.12.2022	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.5.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Sang 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Thirrë’, me kapacitet të instaluar 1820 kw, të ndryshuar”.....	1684

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 343, datë 21.12.2022	Mbi miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.....	1685
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 344, datë 21.12.2022	Mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrjen e afatit procedural të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.....	1692
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 345, datë 21.12.2022	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.8.2021, “Për miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror ‘Albgaz’ sh.a.”, të ndryshuar.....	1693
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 348, datë 28.12.2022	Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë HEC “Arsti” sh.p.k. për zgjatjen e afatit të derogimit	1695
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 349, datë 28.12.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	1697
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 350, datë 28.12.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë KESH sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në portin e Triportit në Gjirin e Vlorës, me fuqi të instaluar 110 mw.....	1698
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 351, datë 28.12.2022	Mbi mosfillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë “Kurum International” sh.a., për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s të shoqëria “Kurum Interntional” sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”.....	1700
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 352, datë 28.12.2022	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar.....	1702
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 353, datë 28.12.2022	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar	1704
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 354, datë 28.12.2022	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ‘Albgaz’ sh.a.”, të ndryshuar.....	1705
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 355, datë 28.12.2022	Mbi miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a.....	1707
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 358, datë 30.12.2022	Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. dhe shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. dhe shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.....	1708



UDHËZIM

Nr. 1, datë 10.1.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E PROGRAMEVE
TË FORMIMIT PROFESIONAL QË
PËRFITOJNË NGA MBËSHTETJA
FINANCIARE, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 2, pika 2 e kreut I, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 5.10.2022, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private”,

UDHËZOJ:

1. Të përfitojnë nga mbështetja financiare për vitin 2023, programet e formimit profesional në fushën “Programim”.

2. Në fushën “Programim” përfshihen: kodimi, programimi kompjuterik, zhvillimi i aplikacioneve, robotika, elektronika, shkenca e të dhënave, siguria kibernetike, intelijenca artificiale, testimi i software-ve, dizajni i software-ve, dizajni i faqeve web, dizajni i përvojës së përdoruesit, dizajni i ndërfaqes së përdoruesit, mësimi makinerik/ automatik, realiteti i shtuar, realiteti virtual ose algoritmet kompjuterike apo fusha të ngjashme të tjera.

3. Fondet për zbatimin e këtij programi për vitin 2023 të mbulohen nga fondet e lira të programit të nxitjes së punësimit.

4. Udhëzimi nr. 29, datë 27.10.2022, “Për përcaktimin e programeve të formimit profesional që përfitojnë nga mbështetja financiare, për vitin 2022”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

VENDIM

Nr. 1, datë 5.1.2023

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pikat “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 1, datë 5.1.2023, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Shkresë e Drejtorisë së Arkivit, lënda kthim-përgjigje “Në vijim të përgjigjes së shkresës nr. 1344/5, datë 27.10.2022”, nr. 24 prot., e datës 1.11.2022, niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, me dy (dy) fletë.

2. Relacion i Drejtorisë së Informacionit, me lëndën “Për shqyrtimin dhe verifikimin e materialeve arkivore në arkivin e Autoritetit, në lidhje me trajtimin e kërkesës nr. 1344 prot., datë 3.8.2022, mbi objekt korrigjimin e të dhënave”, nr. 26 prot., e datës 26.12.2022, niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë.

KRYETARE
Gentiana Sula



VENDIM

Nr. 303, datë 25.11.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALB ENERGY TRADE” SHPK NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “p”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1993/1 prot., datë 22.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Alb Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 276, datë 27.10.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.10.2022 dhe 29.10.2022), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 6.11.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1840/1 prot., datë 3.11.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1840/2 prot., datë 10.11.2022 dhe nr. 1840/4 prot., datë 17.11.2022, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacionin plotësues të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e

licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar të gjithë dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pikës 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; pikës 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikës 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c”; pikës 2.7, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Kontrata e qirasë për zyrat në shërbim të aktivitetit të furnizuesit është aktualisht e vlefshme, por nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, ndaj shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar, jo më vonë se data e fundit e përfundimit të saj, brenda datës 30.9.2027.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë, jo më vonë se data e fundit e përfundimit të saj (brenda datës 30.9.2027).

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti



VENDIM

Nr. 304, datë 25.11.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ERNI SOLAR” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, ME
VENDNDODHJE NË ZONËN BILISHT,
QARKU KORÇË**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1993/2 prot., datë 23.11.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Erni Solar’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën Bilisht, qarku Korçë”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 227, datë 6.9.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erni Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 7.9.2022 dhe 8.9.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 20.9.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1492/1 prot., datë 15.9.2022, ERE i njoftoi shoqërisë fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Po ashtu, me qëllim sqarimin e të dhënave mbi sipërfaqen totale të zonës së projektit apo ndonjë gabimi të mundshëm në referencat përkatëse të kësaj prone që do të shfrytëzojë shoqëria “Erni Solar” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e projektit të centralit fotovoltaik, ERE planifikoi dhe një seancë dëgjimore në datën 26.9.2022, me shoqërinë “Erni Solar” sh.p.k., shoqërinë “NTSP” sh.p.k., shoqërinë “RTS” sh.p.k., Bashkinë Devoll dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Njoftimi për këtë seancë u bë me shkresën nr. 1492/1 prot., datë 16.9.2022.

- Në *e-mail*-in e datës 21.9.2022, protokolluar në ERE me nr. 1492/3 prot., datë 21.9.2022, shoqëria “Erni Solar” sh.p.k., ka depozituar dokumentacion në kuadër të objektit të seancës, ndaj me qëllim shqyrtimin e këtij dokumentacioni, me shkresën e ERE-s nr. 1492/4 prot., u njoftuan palët e interesit për anulimin e seancës së planifikuar. Gjithashtu, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1492/5 prot., datë 22.9.2022 dhe nr. 1492/6 prot., datë 23.9.2022.

- Nga shqyrtimi i sa depozituar nga shoqëria, në lidhje me dokumentet pronësore që do të shfrytëzojë shoqëria “Erni Solar” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e projektit të centralit fotovoltaik, rezulton se ajo ka nënshkruar disa aktmarrëveshje të reja në datën 22.9.2022.

- Duke qenë se në kontratat përkatëse të nënshkruara me MIE-n referohen aktmarrëveshjet e mëparshme, për sa u përket dokumenteve pronësore të territorit ku do të zhvillohet projekti, e po ashtu duke qenë se me aktmarrëveshjet e reja, sipërfaqja totale e disa prej subjekteve nënshkruese të aktmarrëveshjeve ndryshon nga ajo e referuar në kontratën me MIE-n, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 267, datë 14.10.2022, u vendos shtyrja e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 30 ditë pune, me qëllim që të vijojë komunikimi shkresor me MIE-n mbi këto ndryshime apo zhvillimin e një seance të mundshme dëgjimore me palët. Gjithashtu, brenda këtij afati shoqëria duhet të depozitonte dhe dokumentacionin tjetër të munguar të këtij aplikimi.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme me shkresën nr. 1492/8 prot., datë 2.11.2022.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1492/9 prot., datë 3.11.2022 dhe nr. 1492/11 prot.,



datë 10.11.2022, shoqëria ka depozituar të gjithë dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal; dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe lejet nga institucionet respektive. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë gjithë dokumentacionin e kërkuar.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga studimi i fizibilitetit të centralit fotovoltaiik 2 mw rezulton se jetëgjatësia e një paneli shkon 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Erni Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën Bilisht, qarku Korçë, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 323, datë 14.12.2022

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 242, DATË 23.9.2022, TË BORDIT TË ERE-s, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË FSHU SHA, LIDHUR ME KOSTOT QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË LLOGARITJEN E ÇMIMIT ME PAKICË TË ENERGJISË, PËR KLIENTËT FAMILJARË ME KONSUM MBI 800 kwh NË MUAJ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 1, 83, 85, pikat 1 dhe 2, 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 12, nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar; VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; nenit 7, germa “g”, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 189, datë 23.11.2017; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2061/5 prot., datë 12.12.2022, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 242, datë 23.9.2022, të Bordit të ERE-s, ‘Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a. lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me



pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj’ i ndryshuar”,

konstatohet se:

- ERE, me shkresën nr. 1920/1 prot., datë 2.12.2022, ka kërkuar informacion nga shoqëria FSHU sh.a., duke bërë me dije edhe shoqërinë KESH sh.a., lidhur me kostot e blerjes së energjisë elektrike të FSHU sh.a. për muajin dhjetor 2022, mbi energjinë e cila pritët të livrohët nga shoqëria KESH sh.a.

- Shoqëria FSHU sh.a. ka përcjellë në ERE shkresën nr. 7939/3 prot., datë 7.12.2022, (protokolluar në ERE me nr.1920/2, datë 12.12.2022) në të cilën ka bërë me dije kostot që duhen të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë elektrike për klientët familjarë për muajin dhjetor 2022.

- Shoqëria FSHU sh.a. është shprehur, se KESH sh.a., me anë të shkresës me nr. 4820/19 prot., datë 7.12.2022, ka njoftuar shoqërinë FSHU sh.a. për vendimin nr. 9253/1, datë 6.12.2022, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit dhe ka miratuar vendimin nr. 16, datë 5.12.2022, të Këshillit Mbikëqyrës, “Për pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., për muajin dhjetor 2022”, në të cilin është vendosur pezullimi i aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 07, datë 7.9.2022, dhe vendimit të Asamblesë së Aksionarëve nr. 6645/1, datë 8.9.2022, për muajin dhjetor 2022 dhe vijimin e tarifimit për shitjen e energjisë për shoqërinë FSHU sh.a., sipas tabelës së mëposhtme:

Energji e shitur për konsum klientë familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë jo familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë në Tension të mesëm TM, 6/10/20 KV	12 ALL/KWh

- Në kushtet kur nga organet vendimmarrëse të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) është vendosur pezullimi i aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., të miratuara me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, datë 7.9.2022, për muajin dhjetor 2022, duke lënë në fuqi çmimin e shitjes së energjisë për konsumatorët familjarë (pavarësisht sasisë së energjisë elektrike të konsumuar) prej 2.6 lekësh/kwh, atëherë rezulton se kostot e blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a., për këtë

kategori konsumatorësh, për muajin dhjetor 2022, mbeten të pandryshuara.

- Rezulton se vendimmarrja e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 23.9.2022, “Mbi kërkesën e FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”, të ndryshuar me vendimin nr. 254, datë 7.10.2022, dhe vendimin nr. 289, datë 10.11.2022, në asnjë periudhë nuk kanë prodhuar pasoja juridike për palët, sipas parashikimeve të nenit 113 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

- Shoqëria FSHU sh.a. ka kërkuar nga ERE reflektimin e vendimit sa më sipër, në përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë, për klientët familjarë, për muajin dhjetor 2022, duke u aplikuar çmimi i përcaktuar me vendimin nr. 74, datë 23.4.2022, të Bordit të ERE-s.

- Në kushtet kur kostot e blerjes së energjisë elektrike për muajin dhjetor 2022, nga ana e FSHU sh.a. janë të njëjta me kostot e blerjes së energjisë përpara marrjes së vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242, datë 23.9.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”, vlerësojmë se çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen në kushtet e shërbimit universal nga shoqëria FSHU sh.a., për muajin dhjetor 2022, të vijojnë të jenë ato të miratuara në vendimin nr. 74/2022 të Bordit të ERE-s.

- Për muajin dhjetor, vendimi i Bordit të ERE-s nr. 242, datë 23.9.2022, “Mbi kërkesën e FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”, nuk ka krijuar efekte të klientët e shërbimit universal të furnizimit, pasi energjia e konsumuar gjatë muajit dhjetor faturohet në janar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 242, datë 23.9.2022, i ndryshuar të Bordit të ERE-s.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë FSHU sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 324, datë 14.12.2022

**MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT
TË BORDIT TË ERE-s NR. 73, DATË
13.4.2022, “MBI MIRATIMIN E
TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE, SIPAS NIVELIT TË
TENSIONIT, PËR PERIUdhËN
1 MAJ–31 DHJETOR 2022”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “c”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2061/3 prot., datë 12.12.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënie në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendim nr. 73, datë 13.4.2022, miratoi tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022, sipas arsyetimeve dhe konstatimeve të evidentuara në vendimin sipërcituar.

- ERE, me anë të shkresës nr. 1472 prot., datë 18.8.2022, i kërkoj shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. të paraqesë aplikimin për përcaktimin e tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin pasardhës, të shoqëruar me informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- Shoqëria OSSH sh.a. nuk ka paraqitur pranë ERE-s aplikim për përcaktimin e tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin pasardhës bazuar në detyrimet sipas legjislacionit në fuqi.

- Meqenëse llogaritjet për tarifën mesatare të shpërndarjes janë kryer për të gjithë sasinë vjetore të energjisë, që pritej të livrohej në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2022, dhe tarifat e reja filluan të aplikoheshin për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022, diferenca e korrigjueshme për periudhën 1 janar–30 prill 2022, u reflektua në rritje të tarifës mesatare të shpërndarjes për periudhën e mbetur të vitit 2022, me qëllim rikuperimin e të ardhurave të pafaturuara në 4-mujorin e parë të vitit, të cilat duhet të korrigjohen në zbritje në periudhën pasardhëse rregullatore.

- OSSH sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 10971, datë 9.11.2022, ka përcjellë pasqyrat financiare paraprake të vitit 2021, si dhe vetëm pasqyrën e performancës për periudhën e 9-mujorit 2022, ku të dhënat e pasqyruar në këtë korrespondencë janë vetëm të dhëna sintetike dhe joanalitike, nuk janë të argumentuara me shpjegimet përkatëse, sa u takon të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë për periudhën aktuale, si dhe pasqyrojnë të dhëna mbi aktivitetin, të cilat nuk mundësojnë kryerjen e një vlerësimi mbi kostot e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022.

- Shoqëria deri tani nuk ka përcjellë në ERE për shqyrtim planin e investimeve të vitit 2022 dhe përditësimin e planit 5-vjeçar të zhvillimit të shpërndarjes për periudhën 2018–2022, planin e investimeve të vitit 2023, planin e ri të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 2023–2027, në zbatim të parashikimeve të ligjit 43/2015, “Për



sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017.

- Korrigjimi i të ardhurave të kërkuara duhet të marrë në konsideratë dhe investimet e realizuara kundrejt atyre të miratuara, rishikimin e kostove të blerjes së humbjeve, si dhe sasinë e energjisë, e cila është livruar në fakt në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2022, ndaj asaj të parashikuar nga shoqëria.

- Gjithashtu, në kushtet, kur:

- Situata e shpalljes së gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike mbulon vetëm 6-mujorin e parë të vitit 2023, bazuar në parashikimet e VKM-së nr. 584/2021, të ndryshuar, dhe shoqëria gjatë periudhës së mbetur të vitit pasardhës mund të përballet me faktin e blerjes së sasisë së energjisë elektrike në treg të parregulluar, me qëllim mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes në kohën kur çmimet parashikohen të vijnë të mbeten shumë më të larta krahasuar me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi.

- Me përfundimin e gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike, më datë 30 qershor 2023 përfundon edhe vendosja e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë “Furnizuesi i tregut të lirë” sh.a. për shitjen e energjisë elektrike të shoqëria “Furnizuesi i tregut të lirë”, në përputhje me Tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022, të përcaktuara nga Enti Rregullator i Energjisë.

- Vlerësohet, se, nëse ERE konstaton një ndryshim të kostove, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, diferenca e korrigjueshme do të duhet t’i lihet si rezervë shoqërisë, me qëllim përballimin e kostove të paparashikuara të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes përgjatë vitit 2023, si dhe rikuperimin e kapitalit negativ të akumuluar ndër vite.

- Në mënyrë që shoqëria OSSH sh.a., edhe për vitin 2023, të mundet të realizojë aktivitetin për të cilin është licencuar, konform legjislacionit në fuqi bëhet e domosdoshme të vijojë faturimin, bazuar në tarifën e miratuara nga ERE, por duhet të marrë

masa për përcjelljen në ERE të kostove dhe të të ardhurave faktike të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022, si dhe të marrë masa në plotësimin e kërkesave dhe dispozitave të akteve ligjore dhe rregullatore në fuqi.

- Në zbatim të dispozitave të nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe parashikimeve të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017, kur tarifën e miratuara nga ERE rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE do të vendosë masat e përshtatshme kompensuese, sikurse ka vepruar dhe në procedurat e ndjekura sipas vendimmarrjeve respektive të periudhave të mëparshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2023 ose konstatimit të ndryshimit të kostove, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë OSSH sh.a., do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre, sipas përcaktimeve të nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 325, datë 14.12.2022

**MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT
TË BORDIT TË ERE-s NR. 74, DATË
13.4.2022, “MBI VLERËSIMET E ERE-s
PËR KOSTOT E AKTIVITETIT TË
FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT
UNIVERSAL, PËR PERIUDHËN
1.5.2022–31.12.2022”**

Në mbështetje të neneve 16, 19, 20, germa “c”, 83 dhe 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; neneve 15, 19, pika 1, germa “c” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit Transmetimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2061/1 prot., datë 12.12.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënie në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022”,

konstatoi se:

- I licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës jo më vonë se data 1 shtator të vitit aktual duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” dhe metodologjiave përkatëse.

- Këshilli i Ministrave, me anë të vendimit nr. 584, datë 8.10.2021, të ndryshuar me VKM-në nr.

256, datë 29.4.2022 dhe VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022, ka vendosur shpalljen e gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike, e cila i shtrinë efektet deri më 30 qershor 2023. Ky vendim ndër të tjera përcakton një sërë detyrash ndaj OSHEE Group, OST sh.a., dhe KESH sh.a., të cilat lidhen me ndryshimet e çmimeve të importit të energjisë elektrike në tregun e lirë dhe sigurimin e furnizimit të pandërprerë të energjisë elektrike për klientët fundorë.

- Lidhur me miratimin e çmimeve me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2023, evidentojmë, se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 74, datë 13.4.2022, ka vendosur se çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022 janë ato të miratuara me anë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 252, datë 21.12.2021, dhe se klientët, të cilët kanë plotësuar kushtet ligjore dhe/ose teknike për daljen në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike nuk janë subjekt i parashikimeve të pikës 1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022.

- ERE, me shkresën nr. 1470 prot., datë 18.8.2022, ka sjellë në vëmendje të shoqërisë FSHU sh.a. detyrimin për të aplikuar për përcaktimin e çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë, që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në përputhje me nenin 5, pika 3, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të Klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”, dhe nenin 21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

- Shoqëria FSHU sh.a. nuk ka paraqitur pranë ERE-s aplikim për miratimin e çmimeve me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2023, bazuar në detyrimet sipas legjislacionit në fuqi.

- Në mënyrë që shoqëria FSHU sh.a., edhe për vitin 2022, të mund të realizojë aktivitetin për të cilit është licencuar, konform ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhet e domosdoshme të vijojë faturimin bazuar në çmimet e miratuara nga ERE.

- Shoqëria FSHU sh.a. duhet të përcjellë në ERE kostot dhe të ardhurat faktike të aktivitetit të Furnizimit të Shërbimit Universal të energjisë elektrike për vitin 2021 dhe vitin 2022, si dhe të



marrë masa për plotësimin e kërkesave dhe të dispozitave të akteve ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2023, për çmimet me pakicë për klientët fundorë, që shërbejnë nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, ose konstatimit të ndryshimit të kostove bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërive do të bëhet korrigjimi dhe kompensimi përkatës i tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe metodologjive përkatëse, të miratuara nga ERE.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 326, datë 14.12.2022

MBI LËNIEN NË FUQI TË TARIFËS SË PÛRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA “ALBGAS” SHA, PËR VITIN 2023

Në mbështetje të neneve 13, pika 1, 16, pika 2, 17, germa “e”, dhe nenit 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit

21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; “Metodologjisë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 178, datë 18.11.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2061/2 prot., datë 12.12.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ‘Albgaz’ sh.a.” për vitin 2023,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 254, datë 21.12.2021, vendosi për shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s, për vitin 2022, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a.

- Në zbatim të pikës 1, të nenit 21, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s, dhe pikës 1, të nenit 17 të “Metodologjisë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, Operatori i Transmetimit të Gazit Natyror duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim për miratimin e tarifave të reja në ERE, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregulloreje dhe metodologjive përkatëse.

- ERE, me shkresën nr. 1471 prot., datë 18.8.2022, “Kërkesë për informacion”, i është drejtuar shoqërisë “Albgaz” sh.a. që të marrë masa për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 101/1 prot., datë 21.9.2022 (protokolluar me tonën nr. 1471/1 prot., datë 21.9.2022) u përgjigj ndaj kërkesës së sipërcituar, duke theksuar se në rrethanat në të cilat shoqëria zhvillon aktivitetin e përditshëm si OST-G nuk ka pasur zhvillime domethënëse të cilat do të ndikonin drejtpërdrejt në elementet të cilat përcaktojnë metodologjinë e tarifës dhe, në përfundim, shoqëria kërkon që për



vitin 2023 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit.

- Në zbatim të urdhrit të kryetarit të ERE-s u ngrit grupi i punës me objekt “Monitorimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a., në lidhje me zbatimin e planit të investimeve për vitin 2021”.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me anë të shkresës nr. 99/1, datë 5.12.2022, ka bërë me dije, se:

- Po punon ngushtësisht me ekspertë ndërkombëtar të fushës të cilët bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare po hartojnë planin e investimeve afatshkurtër dhe atë afatgjatë të shoqërisë, ku rezultatet e pritshme do të jenë plotësisht në përputhje me nenet 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, si dhe me dërgimin e planit të investimeve ku do të paraqitet dhe evidentimi faktik i aseteve të shoqërisë.

- Shoqëria deklaron, gjithashtu, se është ende në fazë të hershme, sa u takon mundësive të bashkëpunimit me palë të tjera vendëse apo të huaja dhe, në rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve me karakter detyrues me palë të tjera do të njoftohet paraprakisht me shkrim pranë ERE-s në zbatim të dispozitave ligjore dhe rregullatore në fuqi.

- Në përfundim, shoqëria kërkon shtyrjen dhe unifikimin e afateve të parashikuara nga ERE në shkresën sipërcituar deri më datë 30.6.2023.

- Nga sa më sipër, vlerësohet, se:

- Një ndër komponentët kryesorë të përlogaritjes së tarifës së transmetimit të gazit natyror është baza e rregulluar e aseteve, por dhe investimet e pritshme, të cilat pritet të implementohen në periudhën në vijim.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. ushtron aktivitetin e saj konform ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe direktivave të Komunitetit të Energjisë, ku aksesimi në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

- Deri në momentin e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë për miratimin e një tarife për transmetimin e gazit natyror mbështetur në parashikimet e legjislacionit në fuqi, bëhet e nevojshme shtyrja e fuqisë juridike e vendimit nr. 206 datë 16.12.2019.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s, për vitin 2023, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në konstatimet e ERE-s për shoqërinë “Albgaz” sh.a., sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “Albgaz” sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre, sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e”, të ligjit nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 327, datë 14.12.2022

MBI MIRATIMIN E ÇMIMIT VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T’U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI, PËR VITIN 2023

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 10, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM-së) nr. 687, datë 22.11.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e



çmimit vjetor të blerjes të energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi", të ndryshuar; si dhe nenit 15, nenit 21 dhe nenit 22 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2061/4 prot., datë 12.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2023",

konstatoi se:

- Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, ka miratuar "Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi", i rishikuar me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi".

- Nga të dhënat paraprake nga faqja e internetit e Bursës Hungareze të Energjisë (<https://hupx.hu/en/market-data/dam/regular-reports>), është marrë çmimi i deritanishëm mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) për vitin 2022, i cili rezulton në vlerën 271.80 euro/mwh.

- Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, me normë mesatare të shkëmbimit të vitit të fundit, kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2022. Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit, rezulton se kursi mesatar i këmbimit për 11 muajt, tashmë të mbyllur të vitit 2022 (janar–nëntor), rezulton të jetë 119.35 lekë/euro.

- Nga të dhënat paraprake rezulton se çmimi vjetor i blerjes do të jetë 38.93 lekë/kwh. Kufijtë minimalë dhe maksimalë të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, përcaktohen sipas germave "ç" dhe "d", të pikës 2, të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, ku kufiri minimal është çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues (çmim dyshemë) dhe ai maksimal është 15% më i lartë se çmimi i

miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues (çmim tavan).

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 13 datë 16.2.2016, ka vendosur që, tarifa fikse e energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016, do të jetë 7.448 lekë/kw.

- Çmimi maksimal i lejuar mbështetur në përcaktimet e VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, të ndryshuar, është 15% më i lartë se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues: $7.448 * (1 + 15\%) = 8.5652$ lekë/kwh.

- Çmimi i blerjes, i cili rezulton sipas të dhënave paraprake, për vitin 2023, është mbi kufirin maksimal (tavan), pra 15% më i lartë se çmimi i vendosur nga ERE për vitin 2016.

- Bazuar në publikimet e 11-mujorit të HUPX Dam Report, nuk parashikohen ndryshime të tilla në çmimin mesatar të Bursës Hungareze të tilla që të afektojnë në ulje të kufirit të sipërm të çmimit të blerjes së energjisë nga këta prodhues për vitin 2023.

- Lidhur me gjithë sa më sipër, çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2023, rezulton të jetë çmimi prej 8.5652 lekësh/kwh që përcaktohet në kufirin maksimal të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017. Ky çmim do të jetë objekt rishikimi nga ERE, në rast të ndryshimit të elementeve përbërëse të tij.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi prej 8.5652 lekësh/kwh vitin 2023.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,



brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 329, datë 14.12.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 247, DATË 29.9.2022, PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “BURSA
SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE
– ALPEX” SHA NË VEPRIMTARINË E
OPERIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; dhe nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 2061 prot., datë 12.12.2022, “Mbi depozitimin në ERE nga shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë – ALPEX” sh.a. të “Rregullores për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 247, datë 29.9.2022, vendosi të licencojë “Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.

- Në konstatimet e vendimit nr. 247/2022 të Bordit të ERE-s u përcaktua, se: Duke qenë se drafttregullorja për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm, e depozituar në ERE, nuk është miratuar ende, vlerësohet që shoqëria ta depozitojë atë pas miratimit.

- Në vijim të kësaj detyre të lënë, shoqëria me shkresën nr. 966/7 prot., datë 25.11.2022, ka depozituar në ERE “Rregulloren për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm”, e hartuar me qëllim mbrojtjen e të

dhënave sensitive për sa i përket tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike.

- Në mbledhjen e Bordit të datës 14.12.2022, u relatua informacioni me nr. 2061 prot., datë 12.12.2022, “Mbi depozitimin në ERE nga shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë – ALPEX” sh.a., të “Rregullores për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm”.

- Në vijim të sa më sipër vlerësohet ndryshimi i vendimit nr. 247, datë 29.9.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., në aktivitetin e operimit të tregut të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar”, duke hequr paragrafin e shtatë të konstatimeve të tij, me përmbajtje si vijon:

Duke qenë se drafttregullorja për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm, e depozituar në ERE nuk është miratuar ende, vlerësohet që shoqëria ta depozitojë atë pas miratimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë vendimin nr. 247, datë 29.9.2022, si më poshtë:

- Në faqen e dytë hiqet paragrafi i shtatë i konstatimeve të tij, me përmbajtje si vijon:

Duke qenë se drafttregullorja për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm, e depozituar në ERE nuk është miratuar ende, vlerësohet që shoqëria ta depozitojë atë pas miratimit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 331, datë 19.12.2022****MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“H&E ENERGY” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2073 prot., datë 14.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘H&E Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 295, datë 18.11.2022, vendosi për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “H&E Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 19.11.2022 dhe 21.11.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 28.11.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të

ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Aplikuesi ka derdhur për llogari të ERE-s një shumë më të madhe se sa pagesa e aplikimit e përcaktuar në aneksin A, të rregullores së licencimit, ndaj në të tilla rrethana, pagesa shtesë do t’i kthehet.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “H&E Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pikës 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; pikës 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikës 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c”, si dhe pikës 2.5.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “H&E Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**



VENDIM

Nr. 332, datë 19.12.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“BIGWIND” SHPK NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2 mw, ME VENDNDODHJE
NË FSHATIN DARZEZË, NJËSIA
ADMINISTRATIVE DËRMEÑAS,
BASHKIA FIER**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2073/4 prot., datë 14.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Bigwind’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 277, datë 27.10.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Bigwind” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.10.2022 dhe 29.10.2022), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 6.11.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1815/1 prot., datë 3.11.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresat nr. 1815/2 prot., datë 14.11.2022 dhe nr. 1815/4 prot., datë 18.11.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.

- Me vendimin nr. 309, datë 30.11.2022, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me 20 (njëzet) ditë vendimmarrjen e tij mbi aplikimin e shoqërisë “Bigwind” sh.p.k., duke i lënë shoqërisë detyrimin që brenda 10 (dhjetë) ditëve të depozitojë në ERE dokumentacionin që vërteton mbështetjen financiare për realizimin e projektit fotovoltaik, referuar parashikimeve të planit të biznesit.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme me shkresën nr. 1815/5 prot., datë 1.12.2022. Shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1815/6 prot., datë 7.12.2022 (brenda afatit 10-ditor të përcaktuar nga ERE).

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Bigwind” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, ghermat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, ghermat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, ghermat “a”, “b” dhe “c” dhe për pikën 2.1, ghermat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për



procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke vlerësuar dokumentacionin teknik të depozituar nga shoqëria jetëgjatësia e pritshme e centralit fotovoltaiik është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Bigwind” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 333, datë 19.12.2022

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ATEANI ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET “SHUTRI 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 370 kw, DHE “SHUTRI 2”, ME KAPACITET 1600 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 1970 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2073/2 prot., datë 14.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Ateani Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet ‘Shutri 1’, me kapacitet të instaluar 370 kw, dhe ‘Shutri 2’, me kapacitet 1600 kw, me kapacitet total të instaluar 1970 kw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ateani Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2036 prot., datë 5.12.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Shutri 1” dhe “Shutri 2”, me kapacitet të instaluar 1970 kw.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë



në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer një pagesë të pjesshme për aplikimin, në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Ateani Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a” dhe “b” dhe për pikën 2, gjerat “d”.

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se mungon dokumentacioni, si vijon:

Neni 9, “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”

Pika 1, “Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë”:

- Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- gjerat “b”: aplikuesi nuk ka depozituar në ERE, vërtetimet e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti), për shoqërinë “Ateani Energy” sh.p.k., si edhe për administratorin e saj;

- gjerat “c”: në vijim të depozitimit të strukturës së organizimit, shoqëria nuk ka bërë me dije mbi stafin përkatës, i cili do të jetë në funksion të veprimtarisë të prodhimit të energjisë elektrike.

- Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- gjerat “a”: shoqëria nuk ka depozituar në ERE, vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- gjerat “b”: shoqëria “Ateani Energy” sh.p.k. ka përcjellë në ERE pasqyrat e saj financiare për vitet 2019, 2020 dhe ato të ortakut “Ateani” sh.p.k. për vitin 2021, nga të cilat rezultojnë me fitim vetëm ato të ortakut “Ateani” sh.p.k., por nuk është specifikuar nëse pjesë të këtij aktivi likuid/fitimi (kapitali) do të dedikohet për kryerjen e investimit për këtë projekt. Gjithashtu, në përputhje me kërkesat e pikës 1.3 gjerat “b”, shoqëria duhet të kishte sjellë pasqyrat financiare të

vitit 2021 për “Ateani Energy” sh.p.k. Shoqëria “Ateani Energy” sh.p.k. nuk ka specifikuar se me cilat fonde do të mbulojë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike. Po ashtu nuk kemi asnjë vendim asambleje nga ana e ortakëve të saj për financimin e këtij projekti;

- gjerat “c”: shoqëria nuk ka përcaktuar se si do të bëhet financimi i projektit, pasi në analizën financiare ka referuar mënyra dhe shifra të ndryshme; po ashtu shoqëria nuk ka përcjellë dokumentacion mbështetës që justifikon llogaritjet e saj.

- Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- gjerat “a”: aplikuesi është shprehur se data e fillimit të operimit është mars 2023, duke mos specifikuar datën konkrete të fillimit sipas kërkesës së rregullores; po ashtu rezulton se shumatorja e njërive të gjenerimit që shoqëria ka specifikuar është 2 mw, çka nuk përkon me kapacitetin e instaluar të HEC-eve të miratuar me kontratën me MIE-n, i cili rezulton të jetë 1.97 mw dhe pse jemi brenda 10% të lejuar nga legjislacioni në fuqi.

- gjerat “b”: sa konstatohet kontratat me MIE-n janë depozituar në ERE në formatin fotokopje;

- gjerat “c”: konstatohet se kapaciteti i instaluar për të cilin OSHEE sh.a. ka miratuar pikën e lidhjes për HEC-et “Shutri 1” dhe “Shutri 2”, rezulton të jetë 780 kw, ndërkohë që nga kontrata e koncesionit me MIE-n, e ndryshuar, rezulton se ky kapacitet është 1970 kw. Në të tilla rrethana shoqëria duhet të kishte përcjellë në ERE një miratim të pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes, e cila përkon me kapacitetin e instaluar të HEC-eve sipas kontratës me MIE-n;

- gjerat “e”: shoqëria në aplikimin e saj ka deklaruar se periudha e ndërtimit është qershor 2022/mars 2023, por nga ana tjetër kjo shoqëri, sikurse citohet edhe më sipër, me shkresës nr. 04 prot., datë 9.2.2021, ka bërë kërkesë për zgjatjen e afatit të ndërtimit të hidrocentraleve “Shutri 1” dhe “Shutri 2”, pasi nga Bashkia Mat, me njoftimin nr. 2965 prot., datë 15.8.2020, “Kërkesë për ndërprerje të përkohshme të punimeve për ndërtimin e hidrocentraleve për periudhën 15 maj–15 shtator të vitit 2020, ka njoftuar ndërprerjen e përvitshme të punimeve për këtë periudhë kohore, si pasojë e



plotësimeve të nevojave të banorëve të fshatrave Laç, Bruç për vaditjen e të mbjellave sezonale. Në këto kushte rezulton se shoqëria nuk ka dhënë informacionin e duhur në lidhje me fillimin e ndërtimit të veprës, në mënyrë që të llogaritet vlefshmëria e VNM-së paraprake për këtë aplikim.

- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Në kushtet kur ndër të tjera edhe pagesa e aplikimit nuk është kryer e plotë, vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Ateani Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Shutri 1”, me kapacitet të instaluar 370 kw, dhe “Shutri 2”, me kapacitet 1600 kw, me kapacitet total të instaluar 1970 kw.

2. Nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të

bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 334, datë 19.12.2022

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ATEANI ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2073/1 prot., datë 14.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Ateani Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ateani Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2036 prot., datë 5.12.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e



tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Ateani Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin, si vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1.1 germat “a”, “b”, “c”: plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 1.2, germat “a”, “d”: plotësuar;

- pika 2.5, “Dokumentacioni specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike”: plotësuar.

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se mungon dokumentacioni, si vijon:

Neni 9, “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”

Pika 1, “Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë”:

- Pika 1.2, :Dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- germa “b”: shoqëria nuk ka depozituar në ERE vërtetimet e gjendjes gjyqësore për shoqërinë si edhe për administratorin;

- germa “c”: shoqëria ka depozituar në ERE strukturën organizative të saj, por nuk ka përcjellë informacion lidhur me stafin përkatës, i cili do të jetë në funksion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- germa “a”: Shoqëria nuk ka depozituar në ERE vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- germa “b”: në vijim të depozitimit të informacionit të sipërpërmendur, shoqëria “Ateani Energy” sh.p.k. nuk ka deklaruar në asnjë moment se me çfarë fondesh do të mbulojë veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike; në kushtet kur kjo shoqëri është e përbërë nga dy ortakë, vlerësohet se duhej të përcaktonte me anë të vendimit të

asamblesë se cili nga ortakët do të ndërmarrë mbulimin financiar;

- germa “c”: shoqëria nuk ka përcjellë plan-biznesi për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në kuptim të kësaj kërke të rregullores.

- Po ashtu evidentohet se shoqëria nuk ka të parashikuar në objektin e saj në QKB, ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Ateani Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 335, datë 19.12.2022

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 119, DATË
24.5.2022, “MBI KËRKESËN E
SHOQËRISË ‘IRARBA ENERGJI’ SHPK
PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË
PALUAJTSHME, NË FAVOR TË BANKËS
SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË SHA”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 53, pika 2, dhe nenit 113, të ligjit nr. 144/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2073/3 prot., datë 14.12.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 24.5.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Irarba Energji’ sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme, në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 119, datë 24.5.2022, vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme, në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., me kusht që, brenda 3 muajve nga ky miratim, të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me bankën për këtë transferim të aseteve, përfshirë dhe listën e aseteve të paluajtshme, së bashku me vlerën përkatëse të secilit prej tyre.

2. Mosdepozitimi i dokumentacionit, sipas përcaktimeve të pikës 1, e bën këtë miratim të pavlefshëm.

3. Dhënia e miratimit nga ERE për transferimin e aseteve nuk e çliron shoqërinë “Irarba Energji” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e organeve të tjera, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në çdo kohë nga ERE.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e sipërcituar me shkresën nr. 194//5 prot., datë 30.5.2022.

- Brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 119/2022, shoqëria “Irarba Energji” sh.p.k. ka depozituar në ERE kontratat/marrëveshjet barrësuese përkatëse të nënshkruara me “Bankën e Bashkuar të Shqipërisë” sh.a., por në to është përcaktuar vetëm vlera totale e aseteve dhe nuk është dokumentuar lista e detajuar e aseteve të paluajtshme, ku të përcaktohet vlera e secilit prej tyre.

- Duke marrë në konsideratë faktin që shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 119/2022, vlerësohet që t'i lihet detyrë, që brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi të depozitojë në ERE informacion/dokumentacionin përkatës mbi listën e detajuar të aseteve të paluajtshme, që i shërbejnë veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, së bashku me vlerën përkatëse të secilit prej tyre, të cilat barrësohen në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar se organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit. Po ashtu, në nenin 113 të KPA-së është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti administrativ, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 119, datë 24.5.2022, ndryshon si vijon:

“1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme, në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., me kusht që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi, të depozitojë në ERE informacion/dokumentacionin përkatës mbi listën e detajuar të aseteve të paluajtshme, që i shërbejnë veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, së bashku me



vlerën përkatëse të secilit prej tyre, të cilat barrësohen në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 339, datë 21.12.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
ERE-s NR. 28, DATË 14.2.2022, MBI
KËRKESËN E OSSH SHA, PËR
NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË ERE-s
NR. 181, DATË 23.11.2016, “PËR DISA
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 104,
DATË 23.6.2016, TË BORDIT TË ERE-s,
‘MBI PËRCAKTIMIN E
METODOLOGJISË SË VLERAVE
REFERUESE, NË RAST SE TË DHËNAT
E MATJES JANË PËRKOHËSISHT TË
PADISPONUESHME DHE TË
PAARRITSHME, SI DHE MBI
SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË ERE-
s NR. 49, DATË 21.10.2004, DHE NR. 146,
DATË 24.12.2013”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 76, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike me nr. 2094/2 Faqe|1680

prot., datë 19.12.2022, “Për një ndryshim në vendimin nr. 28, datë 14 shkurt 2022, të Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e OSSH sh.a., për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, dhe nr. 146, datë 24.12.2013”.

konstatoi se:

- ERE me vendimin nr.28, datë 14 shkurt 2022, vendosi: Pranimin e pjesshëm të kërkesës së bërë nga OSSH sh.a. për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr.49, datë 21.10.2004, dhe nr. 146, datë 24.12.2013”.

- Ndryshimet e pranuar lidhen kryesisht me rastet kur furnizuesi merr dijeni nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesi në të dhënat e matjes). Në këto rrethana faturimi i energjisë elektrike do të bëhet me vlerë referuese. Kjo vlerë do të përlogarit bazuar në të njëjtën konsum të muajit respektiv të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj.

- Ndryshimet e pranuar me vendimin nr. 28, datë 14 shkurt 2022, i shtrojnë efektet juridike deri në datë 31.12.2022.

- Me shkresën e tyre të protokolluar me nr. 10620 prot., datë 1 nëntor 2022, OSSH sh.a. i është drejtuar ERE-s, me qëllim parashtrimin e kërkesës për shtrirjen e efekteve të vendimin e Bordit të ERE-s nr. 28/2022 deri në fund të vitit 2023.

- Në mbështetje të një kërkesë të tillë, ata kanë paraqitur në formë tabelare një simulim të llogaritjes së këtyre vlerave me vendimin e mëparshëm të ERE-s (nr. 181, datë 23 nëntor 2016), si dhe vlerat referuese në fuqi (vendimin nr. 28, datë 14 shkurt 2022, i Bordit të ERE-s).



- Diferenca e përftuar nga ky ndryshim metodologjie në llogaritje është rreth 11 milionë kwh (29,805,737 kwh–18,828,680 kwh). Kjo shpjegon se sasia e 29,805,737 kwh që vjen nga aplikimi i vendimit nr. 28/2022 është me afër faktit krahasuar me metodologjinë e vjetër (vendimin nr. 181/2016).

- OSSH sh.a. ka argumentuar në mbështetje të propozimit: Diferenca (në rënie) e konsumit të vitit 2020, konsum që llogaritet sipas metodologjisë së vendimit nr. 181, si shkak i pandemisë COVID 19, ku rënies së konsumit i shtohet edhe pamundësia e leximit; Rritja e konsumit të energjisë elektrike menjëherë pas periudhës së emergjencës COVID 19 (vjeshtë, dimër 2020); Për kontratat e reja është aplikuar mesatarja e muajve me matje, ndërkohë që, në kushte të tjera (vendimi nr. 181, datë 23 nëntor 2016) do të bënte që ato të llogariteshin me konsum 0 (zero); Kontratat që nuk kanë pasur historik faturimi, pra, që në të shkuarën e tyre llogariteshin për më se 1 (një) vit me konsum 0 (zero), me metodologjinë e re të llogaritjes (vendimi nr. 28, datë 14.2.2022, i Bordit të ERE-s), janë faturuar sipas mesatares së konsumit të vitit të fundit, duke qenë më afër realitetit.

- OSSH sh.a., sa u përket dy krahasimeve të metodologjive të aplikuara për kontratat në të cilat është aplikuar vlera zëvendësuese për periudhën shkurt–gusht 2022, ka konstatuar se diferenca në sasi kwh midis dy metodologjive të aplikuara është e madhe, afro 11 milionë kwh. Për sa u përket faktorëve që OSSH sh.a. ka përmendur, si pasojë e diferencës që vjen mes dy metodologjive, vlerësojmë, si më poshtë:

- Aplikimi i vlerës zëvendësuese që përllogaritet bazuar në të njëjtin konsum të muajit respektiv të vitit të mëparshëm, kur të dhënat e matjes janë të padisponueshme, sipas vendimit nr. 28/2022, i afrohen me shumë konsumit faktik.

- Për kontratat e reja është aplikuar mesatarja e muajve me matje, ndërkohë që, në kushte të tjera (vendimi nr. 181, datë 23 nëntor 2016) do të bënte që ato të llogariteshin me konsum 0 (zero).

- Kontratat që nuk kanë pasur historik faturimi, pra, që në të shkuarën e tyre llogariteshin për më se 1 (një) vit me konsum 0 (zero), me metodologjinë e re të llogaritjes (vendimi nr. 28, datë 14 shkurt 2022, të Bordit të ERE-s), janë faturuar sipas mesatares së konsumit të vitit të fundit, duke qenë më afër realitetit.

- Nga verifikimet e bëra për ankesat e dërguara në ERE për mosmarrëveshje nga klientët, vërejmë vetëm 1 (një) ankesë të ardhur për vlerë referuese të përcaktuar në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 28/2022. Për këtë arsye, vlerësohet aplikimi i metodologjisë së vlerave referuese sikurse përcaktohet në pikat 2 dhe 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 28/2022, për një periudhë të pacaktuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së OSSH sh.a. për ndryshimin e vendimit nr. 28, datë 14.2.2022, të Bordit të ERE-s, “Mbi kërkesën e OSSH sh.a., për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.0\6.2016, të Bordit të ERE-s, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme”, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013”.

2. Pika 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 28, datë 14.2.2022, ndryshon, si më poshtë vijon: “Ndryshimet e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të vendimit nr. 28, datë 14.2.2022, i shtrijnë efektet juridike deri në një afat të pacaktuar.”.

3. Pika 5 e vendimit nr. 28, datë 14.2.2022, shfuqizohet.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e përfshira për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2023.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 340, datë 21.12.2022****MBI RINOVIMIN E LICENCËS NR. 395,
SERIA F18, TË SHOQËRISË “ENERGJI
ASHTA” SHPK NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përpiluar nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 314, datë 06.12.2022 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ENERGJI ASHTA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 7.12.2022 dhe 8.12.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 16.12.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për rinovimin licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e kërkuar nga neni 16, “Rinovimi i licencës”; formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1 (neni 16, germa “a”); çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar

në aplikimin për pajisje me licencë (neni 16, germa “b”); informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur) (neni 16, germa “c”) shtojca 1.I; të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe atë të rregullimit në ERE (neni 16, pika 7).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Po ashtu shoqëria nuk rezultoi debitor e pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Duke qene se licenca nr. 395, seria F18, e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, përfundon afatin e saj në datën 30.1.2023, vlerësohet që afati i rinovimit të saj të fillojë nga data 31.1.2023.

- Nga aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k. rezultoi se dokumentacioni është i plotësuar tërësisht si vijon:

- Neni 16, pika 1, germa “a”, “b”, “c”: plotësuar;

- Neni 16, pika 7: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 395, seria F18, të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 26, datë 30.1.2018, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), duke filluar nga data 31.1.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**



VENDIM

Nr. 341, datë 21.12.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALKAN
ENERGY TRADE” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2094 prot., datë 19.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Balkan Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 319, datë 12.12.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria, me *e-mail*-in e datës 13.12.2022, protokolluar në ERE me nr. 2015/1, datë 14.12.2022, ka përcjellë pjesërisht dokumentacion që lidhet me këtë aplikim.

- ERE me shkresën nr. 2015/2 prot., datë 15.12.2022, ka njoftuar shoqërinë për mosfillimin e procedurës, duke evidentuar edhe dokumentacionin e munguar dhe, po ashtu, ka bërë me dije se në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në rast se, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, shoqëria

paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, në zbatim të aneksi A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1.1 germat “a”, “b”, “c”: plotësuar;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 1.2, germat “a”, “c”, “d”: plotësuar;

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 1.3, germa “a” dhe “c”: plotësuar;

- Dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 2.5: plotësuar;

- Nga ky aplikim rezultojnë mungesa në dokumentacionin, si më poshtë:

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- germa “b”: Aplikuesi nuk ka përcjellë vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj.

Pika 1.3 “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE balancat aktive që disponon në llogarinë bankare.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.



- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 342, datë 21.12.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 83, DATË 31.5.2019, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SANG 1’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘THIRRË’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1820 kw, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurale ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me

nr. 2094/1 prot., datë 19.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.5.2019, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Sang 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Thirrë’, me kapacitet të instaluar 1820 kw’, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 83, datë 31.5.2019, të ndryshuar, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Sang 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë”, me kapacitet të instaluar 1820 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “Sang 1” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor nr. 97, prot., datë 8.5.2017, përpara datës 27.4.2022.

- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje dhe më tej ka vijuar korrespondencat drejtuar shoqërisë, në lidhje me plotësimin e këtij kushti.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 845/1, datë 31.5.2022, shoqëria “Sang 1” sh.p.k. ka bërë me dije se ka aplikuar dhe është në pritje të rinovimit të lejes të përdorimit të burimit ujor nga Agjencia e Mbrojtjes së Burimeve Ujore (AMBU).

- ERE, në vijim të takimit të datës 2.6.2022, me përfaqësues të AMBU-së, ka shkëmbyer korrespondenca të vazhdueshme me këtë institucion, ku së fundi edhe me shkresën nr. 1833 prot., datë 18.10.2022, në lidhje me konstatimin nga AMBU-ja të disa HEC-eve që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, pa pasur leje të përdorimit të burimit ujor, duke i kërkuar ndër të tjera informacion në lidhje me mënyrën se si do të konsiderohen subjektet që kanë aplikuar për rinovimin e lejes për përdorimin e burimit ujor përkatës dhe gjatë këtij procesi i përfundon afati i vlefshmërisë së lejes me të cilën është pajisur, siç rasti i shoqërisë “Sang 1” sh.p.k., së cilës i ka përfunduar leja në datën 27.4.2022 dhe ka bërë me dije ERE-n se ka aplikuar fillimisht në datën 16.3.2022 dhe më pas ka riaplikuar përsëri në datën 26.4.2022.

- Në përgjigje të sa më sipër me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1833/1, datë 21.10.2022, AMBU, ndër të tjera ka kthyer përgjigje edhe për shoqërinë “Sang 1” sh.p.k., duke cilësuar se kjo shoqëri ka aplikuar për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujor për HEC “Thirrë” dhe aplikimi është në fazën e kryerjes së pagesës së



tarifës për marrjen e lejes nga subjekti përfitues.

- Në vijim me shkresën nr. 2055/1 prot. datë 14.12.2022, shoqëria “Sang 1” sh.p.k. ka depozituar vendimin nr. 23, datë 12.10.2022, “Për miratimin e saktësimit të koordinatave dhe rinovimin e lejes, HEC “Thirrë” dhe lejen për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor nr. 433 , datë 24.10.2022, me afat vlefshmërie 5 vjet.

- Me depozitimin e dokumentacionit si më sipër nga shoqëria “Sang 1” sh.p.k. vlerësojmë që pika 2 e vendimit të Bordit nr. 83/2019, të ndryshuar, të ndryshojë dhe bëhet:

“2. Shoqëria “Sang 1” sh.p.k. të përcjellë në ERE jo më vonë se data 13.10.2027, lejen e përdorimit të burimit ujqor me afat të rinovuar (data e përfundimit të lejes 12.10.2027).”.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e dispozitivit të vendimit nr. 83/2019, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “Sang 1” sh.p.k. të përcjellë në ERE jo më vonë se data 13.10.2027, lejen e përdorimit të burimit ujqor me afat të rinovuar (data e përfundimit të lejes 12.10.2027).”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petril Ahmeti

VENDIM

Nr. 343, datë 21.12.2022

MBI MIRATIMIN E KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “P”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.2 dhe të pikës 2, të “Programit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a.)”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2020; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike me nr. 2094/7 prot., datë 19.12.2022, “Mbi miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin e bordit nr. 257, datë 21.12.2020, ka miratuar Programin e Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSSH sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 239, datë 22.9.2022, vendosi të fillojë procedurën për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.

- ERE bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 24.9.2022 dhe 26.9.2022) dhe në përfundim të afatit prej 20 ditëve pune (data e fundit 21.10.2022), nuk rezultoi që të ketë komente apo rekomandime nga palët e treta.

- Me shkresën nr. 289/6 prot., datë 27.9.2022, është njoftuar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoriteti i Konkurrencës (AK) dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE), ku i është kërkuar të shprehin komentet apo rekomandimet e tyre brenda 20 ditëve pune.

- Për sa më sipër njoftuar, ka kthyer përgjigje vetëm Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 585/2 prot., protokolluar në ERE me nr. 289/7 prot., datë 19.10.2022, i cili është shprehur se kjo



procedure nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

- Me shkresën nr. 289/5 prot., datë 27.9.2022, u njoftua për këtë vendimarrje Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), i cili me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 289/8 prot., datë 31.10.2022, ka depozituar draftkontratën me ndryshime, por pa dhënë asnjë argument se ku është bazuar për të propozuar këto ndryshime.

- “Zyrtari i Pajtuëshmërisë” është zëvendësuar me togfjalëshin “Zyrtari i Përputhshmërisë”. Në draftkontratën e përgatitur nga ERE është vendosur emërtimi “Zyrtari i Pajtuëshmërisë”, duke u bazuar në përcaktimet e nenit 3, pika 92, nenit 72, pika 3, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe përcaktimet e pikave 1.2, 2, 3, 10 dhe 11, të Programit të Pajtuëshmërisë së OSSH sh.a., të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2020. Në këto rrethana, ky ndryshim i shoqërisë në draftkontratë vlerësohet të mos pranohet.

- Draftkontrata e depozituar nga ana e OSSH sh.a. ka ndryshime nëpër fjalë, të cilat nuk ndryshojnë thelbin apo qëllimin e këtyre fjalëve, dhe duke qenë se shoqëria nuk ka paraqitur asnjë argument për këto ndryshime, vlerësohet që të mos pranohen.

- Po ashtu, konstatohet se në draftkontratë ka dhe rikonceptime dhe ndryshime të përcaktimeve, si p.sh. gerrat A-D të draftkontratës së përgatitur nga ERE, afati e depozitimit në ERE të raportit vjetor nga ana e ZP-së, afati për detyrimet konfidenciale të zyrtarit pas përfundimit të kontratës, data e hyrjes në fuqi dhe afati i kontratës, apo për sa u përket kriterëve përzgjedhëse dhe profesionale të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë, ndryshime të cilat nuk janë argumentuar nga ana e OSSH sh.a., ndaj vlerësohet që të mos pranohen.

- Përveç sa më sipër, në draftkontratën e depozituar, të ndryshuar nga OSSH sh.a., rezulton se janë hequr përkatësisht: pikat 3.1.4–3.1.16, të cilat kanë përcaktime të detajuara në lidhje me përgjegjësitë e zyrtarit; pika 6.3, ku përcaktohet se nga se përbëhet pagesa e zyrtarit; pika 7.5, ku përcaktohet se të dyja palët bien dakord, që për qëllim të kësaj kontrate, duhet të përjashtohet gjykimi tregtar si formë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve; pika 9.4, ku përcaktohet se me

hyrjen në fuqi të kontratës, zyrtari depoziton në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë 1 (një) kopje të kontratës dhe shtojcës së saj, në gjuhën angleze.

Duke qenë se shoqëria nuk ka paraqitur asnjë argument për heqjen nga kontrata të këtyre përcaktimeve, vlerësohet që të mos pranohen këto ndryshime.

- Në draftkontratën e depozituar të ndryshuar nga OSSH sh.a. konstatohet se janë përcjellë të plotësuar pjesët që lidhen me emrin e administratorit të shoqërisë (i cili, gjithsesi, rezulton se është ndryshuar), adresa, organet drejtuese apo të dhëna të tjera. Sqarojmë se ERE miraton kontratën tip dhe pjesët e lëna bosh dhe të shoqëruara me udhëzimin përkatës, plotësohen kur nënshkruhet kontrata nga palët.

- Vlerësohet se duhet pranuar ndryshimi që OSSH sh.a. ka bërë në pikën 4.1.4 të draftkontratës, për arsye se ZP monitoron pajtuëshmërinë e sistemit të shpërndarjes, e si e tillë ai duhet të ketë akses të kontaktet me pjesëmarrësit e sistemit të shpërndarjes dhe jo me të gjithë pjesëmarrësit e tjerë të tregut të energjisë elektrike.

- Gjithashtu, vlerësohet se duhet pranuar ndryshimi që OSSH ka bërë në pikën 5.5.7 të draftkontratës së përgatitur nga ERE, duke zëvendësuar “planet 10-vjeçare (dhjetëvjeçare)” me “planet afatgjata”, siç specifikohet dhe në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, sa u takon planeve të zhvillimeve të rrjetit të shpërndarjes.

- Në kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjejmë parashikim në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrimet e palëve, duke përfshirë shërbimet që duhet të ofrojë zyrtari, të drejtat e zyrtarit, të drejtat dhe detyrimet e OSSH sh.a., pagesat dhe detyrimet financiare për shërbimet e zyrtarit, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve. Pagesa e Zyrtarit të Pajtuëshmërisë caktohet nga OSSH sh.a.

- Kjo kontratë hyn në fuqi në datën kur ajo nënshkruhet nga palët dhe mandati i Zyrtarit të Pajtuëshmërisë fillon ditën tjetër të punës pas nënshkrimit. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e nënshkrimit. Në shtojcën 1, përfshihen kriteret përzgjedhëse të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë.

- Në pikën 1.2 dhe pikën 2 të Programit të Pajtuëshmërisë parashikohet se OSSH sh.a.



përcakton, Zyrtarin e Pajtueshmërisë, i cili më pas miratohet me vendim të Bordit të ERE-s.

- Për gjithë sa më sipër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga miratimi i kontratës për ofrimin e shërbimeve dhe kritereve të përzgjedhjes, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. duhet të përcjellë për miratim në ERE Zyrtarin e Pajtueshmërisë, pas emërimit nga organet drejtuese të tij.

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. duhet të dokumentojë në ERE plotësimin nga Zyrtari i Pajtueshmërisë të kritereve të përcaktuara në shtojcën 1 të kontratës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. (bashkëlidhur).

2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi mbi miratimi e Kontratës, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. duhet të përcjellë për miratim në ERE Zyrtarin e Pajtueshmërisë, pas miratimit nga organet drejtuese të saj.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. duhet të dokumentojë në ERE plotësimin nga Zyrtari i Pajtueshmërisë të kritereve të përcaktuara në shtojcën 1 të kontratës.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KONTRATË

PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA

Nr. [•] [Tiranë], më [•] [•] [2022]

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – OSSH sh.a., një shoqëri e themeluar në mënyrë të vlefshme dhe që funksionon në zbatim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me NUIS L81530018E, me seli në adresën [•] (këtu dhe më poshtë “OSSH sh.a.”), e përfaqësuar rregullisht nga [Administratori] [•], që vepron në bazë të Statutit të shoqërisë,

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Pajtueshmërisë], me numër personal [•] dhe adresë banimi [•] (këtu dhe më poshtë “Zyrtari”),

këtu dhe më poshtë në mënyrë të përmbledhur ju referohemi si “Palët” dhe secilit në mënyrë të veçantë si “Pala”, duke marrë parasysh që:

A. Me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (këtu dhe më poshtë “ERE”) nr. 216, datë 11.10.2018, është miratuar transferimi i licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, të shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.), e vlefshme deri me datë 27.10.2044.

B. OSSH sh.a. është person juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike.

C. Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2020, është miratuar Programi i Pajtueshmërisë së OSSH sh.a. (këtu dhe më poshtë “Programi”).

D. Me vendimin nr. [•], datë [•] të [organeve përkatëse] të OSSH sh.a., dhe me vendimin e Bordit të ERE-s nr. [•] datë [•] është emëruar Zyrtari i Pajtueshmërisë së OSSH sh.a. (këtu dhe më poshtë “Zyrtari”).

OSSH sh.a. dhe Zyrtari lidhin këtë Kontratë për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë



(këtu e më poshtë “Kontrata”) sipas termave dhe kushteve të mëposhtëm.

1. SUBJEKTI I KONTRATËS

1.1 Nëpërmjet kësaj kontrate, Palët bien dakord që Zyrtari do të ofrojë shërbimet e tij për OSSH sh.a., duke vepruar brenda kompetencave dhe sipas përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar (këtu dhe më poshtë “Ligji”), akteve të tjera ligjore në fuqi, Programit dhe kësaj Kontrate. OSSH sh.a. duhet të sigurojë zbatimin e masave të nevojshme për Zyrтарin, që ai të jetë në gjendje të sigurojë shërbimet e tij dhe të paguhet për këto shërbime.

1.2 Programi i Pajtueshmërisë së OSSH sh.a. është miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2020. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Zyrtari konfirmon se i kupton dhe është dakord me dispozitat e Programit, natyrën e tij kufizuese, detyrimet dhe të drejtat që lindin për të në zbatimin e përcaktimeve të këtij Programi.

1.3 Kjo kontratë do të konsiderohet si kontratë tregtare për ofrimin e shërbimeve të mbyllura, sipas termave dhe kushteve të vendosur në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore në fuqi. Dispozitat e përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet civile dhe tregtare midis Palëve duhet të aplikohen në Kontratë pa dëmtuar zbatimin e kërkesave specifike të krijuara me Ligj.

2. KUALIFIKIMET DHE PAVARËSIA E ZYRTARIT

2.1 Përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, Zyrtari duhet të ketë përmbushur kriteret përzgjedhëse të pasqyruara në shtojcën 1.

2.2 Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të jetë i pavarur gjatë ofrimit të shërbimeve për OSSH sh.a. Pavarësia e tij duhet të sigurohet përgjatë gjithë vlefshmërisë së Kontratës dhe me mbarimin e saj, si specifikohet këtu dhe më poshtë, me aplikimin e kërkesave të mëposhtme:

2.2.1 Zyrtari i Pajtueshmërisë nuk duhet të kryejë asnjë detyrë tjetër profesionale dhe nuk duhet të lejohet që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kryejë ndonjë funksion tjetër, të marrë pjesë në biznese ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të shoqërisë vertikalisht të integruar ose me shumicën e aksioneve të saj, ose me çdo shoqëri të lidhur me aktivitetin e energjisë elektrike, përveç shpërndarjes së energjisë elektrike:

2.2.1.1 gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës;

2.2.1.2 për një periudhë prej të paktën 4 (katër) vjetësh pas përfundimit të kësaj Kontrate;

2.2.2 Zyrtari i Pajtueshmërisë nuk duhet të ketë interes ekonomik ose të marrë përfitime financiare, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga shoqëritë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre, ose nga shoqëritë që kanë lidhje me aktivitetin e energjisë elektrike, përveç shpërndarjes së energjisë elektrike.

2.3 Zyrtari duhet të refuzojë çdo udhëzim ose kërkesë të OSSH sh.a., organeve të shoqërisë, të drejtuesve, punonjësve dhe/ose çdo përfaqësuesi tjetër që është ose mund të jetë në konflikt me mandatin dhe/ose pavarësinë e tij, apo të çdo organi që ushtron kontroll në OSSH sh.a.

2.4 Në rastet kur statusi i kërkuar i pavarësisë dhe kriteret e përzgjedhjes ndryshojnë gjatë vlefshmërisë së kësaj Kontrate, Zyrtari do të informojë menjëherë, por në çdo rast jo më vonë se dita tjetër e punës, pasi është vënë në dijeni për këtë ndryshim, administratorin e OSSH sh.a. dhe të ofrojë shpjegime me shkrim, që arsyetojnë dokumentacionin përkatës dhe, kur është e nevojshme, të ofrojë zgjidhje për ta korrigjuar.

2.5 Në rastin e referuar në pikën 2.4, Zyrtari duhet të tërhiqet përkohësisht nga pozicioni i tij, derisa [organi përkatës] i OSSH sh.a. të marrë vendim, në lidhje me bashkëpunimin e mëtejshëm me Zyrтарin ose të depozitojë në ERE kërkesën për miratimin e përjashtimit të Zyrтарit. Kur është e nevojshme, [organi përkatës] i OSSH sh.a. mund të konsultohet me ERE-n para se të marrë vendimin.

3. SHËRBIMET E ZYRTARIT

3.1 Zyrtari ka për detyrë të monitorojë zbatimin e përcaktimeve të Programit dhe të raportojë mbi këtë zbatim, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në Ligj dhe te vetë Programi. Zyrtari është veçanërisht përgjegjës, për sa vijon:

3.1.1 monitorimin e respektimit të detyrimeve ligjore të Programit, si dhe ndryshimet apo rishikimet e nevojshme të tij;

3.1.2 hartimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat e marra për zbatimin e Programit dhe dorëzimin e këtij raporti në ERE dhe te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës;

3.1.3 raportimin e vazhdueshëm në organet përkatëse të shoqërisë OSSH sh.a. dhe nxjerrjen e rekomandimeve për zbatimin e Programit;



3.1.4 raportimin tek [organi përkatës] i OSSH-së dhe stafi menaxherial i OSSH sh.a. lidhur me mosmarrëveshjet e mundshme, në kuadër të zbatimit të programit; dhe

3.1.5 përgatitjen me shkrim të masave dhe propozimeve për të rregulluar problematika të tilla, duke përfshirë këtu dhe rekomandime për udhëzime të brendshme;

3.1.6 investigimin e konfliktit të mundshëm ose ekzistues të interesit për drejtuesit dhe punonjësit e OSSH sh.a., ofrimin e konsultimeve në lidhje me parandalimin e konflikteve të mundshme ose korrigjimin e konflikteve ekzistuese të interesit, si dhe ofrimin e zgjidhjeve të propozuara për masat e nevojshme korrigjuese;

3.1.7 raportimin në ERE për shkeljet në lidhje me zbatimin e Programit, në rast se ato nuk janë korrigjuar brenda një afati të arsyeshëm;

3.1.8 ndjekjen e mbledhjeve/takimeve të organeve përkatëse të OSSH-së dhe, kur është e përshtatshme, konsultimin e pjesëmarrësve në mbledhje/takime për kërkesat e Programit, në rastet kur takimet trajtojnë çështjet e mëposhtme:

3.1.8.1 kushtet për aksesin në sistemin e shpërndarjes dhe përdorimin e rrjetit të shpërndarjes, alokimin e kapaciteteve të shpërndarjes dhe transparencën,

3.1.8.2 projektet në zbatim lidhur me operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes;

3.1.8.3 blerjet dhe shitjet e energjisë për nevoja të mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes etj.

3.1.9 paraqitjen e propozimeve për organet përgjegjëse të OSSH sh.a., sipas miratimit paraprak nga ERE, në lidhje me planin afatgjatë për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes ose investimeve individuale në rrjetin e shpërndarjes;

3.1.10 monitorimin e pajtueshmërisë së OSSH sh.a. me dispozitat e Ligjit dhe Programit, duke rregulluar konfidencialitetin në aktivitetet e shoqërisë OSSH sh.a.;

3.1.11 monitorimin e ndryshimeve ligjore dhe rregullatore, në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e Programit;

3.1.12 ofrimin e konsultimeve në lidhje me hartimin dhe miratimin e akteve të brendshme të kompanisë OSSH sh.a. dhe pasqyrimin e ndryshimeve ligjore dhe rregullatore në këto akte;

3.1.13 monitorimin e listës së autorizimeve të dhëna për akses në transaksionet ose veprimet *online* (duke përfshirë aksesin në bazën e të dhënave të shoqërisë OSSH), të cilat paraqesin një rrezik shpërndarjeje të informacionit të ndjeshëm tregtar në pronësi të OSSH sh.a.;

3.1.14 përgjigjen e pyetjeve të drejtuesve dhe të punonjësve të OSSH sh.a., në lidhje me Programin;

3.1.15 udhëzimin e drejtuesve dhe punonjësve të OSSH sh.a. për Programin dhe zbatimin e tij;

3.1.16 koordinimin e komunikimit me ERE-n, autoritetet e tjera përkatëse, pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike dhe/ose palë të tjera të treta, në lidhje me zbatimin e Programit.

3.2 Lista e shërbimeve të ofruara nga Zyrtari, të caktuara në pikën 3.1, duhet të konsiderohet si fundore. Çdo shërbim tjetër mund të përfshihet vetëm nëse iu referohet qartë dispozitave të Ligjit ose Programit, duke ndryshuar këtë Kontratë.

3.3 Zyrtari, ndërkohë që ofron shërbimet e tij tek OSSH sh.a., duhet të jetë i lidhur nga detyrimet konfidenciale njësoj si drejtuesit dhe punonjësit e shoqërisë OSSH sh.a., të vendosura sipas Programit. Detyrimet konfidenciale duhet të jenë plotësisht të vlefshme gjatë gjithë mandatit të Zyrtarit dhe për një periudhë prej 4 (katër) vjetësh pas përfundimit të Kontratës. Mosplotësimi i detyrimeve të konfidencialitetit nga Zyrtari do të konsiderohet si prishje e kësaj kontrate.

3.4 Të gjitha rezultatet e shërbimeve të ofruara nga Zyrtari, sipas pikës 3.1, duhet të paraqiten me shkrim ose me gojë, siç kërkohet nga shërbimet përkatëse, derisa të kërkohet një formë specifike nga Zyrtari sipas Programit ose kësaj Kontrate.

3.5 Të gjitha dokumentet e përgatitura nga Zyrtari duhet të jenë në gjuhën shqipe. Raporti vjetor i hartuar nga Zyrtari duhet të përkthehet në gjuhën angleze dhe të depozitohet nga ai në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.

4. TË DREJTAT E ZYRTARIT

4.1 Në mënyrë që të përmbushë detyrimet për ofrimin e shërbimeve për shoqërinë OSSH sh.a., sipas pikës 3.1 të kësaj Kontrate, Zyrtari ka të drejtë:

4.1.1 të kërkojë kushtet e duhura financiare dhe organizuese, që i mundësojnë atij ofrimin e shërbimeve në mënyrë eficiente;

4.1.2 të kërkojë bashkëpunim me drejtuesit dhe punonjësit e OSSH sh.a. kur është e nevojshme për zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë;



4.1.3 të ketë akses tek të gjitha informacionet e nevojshme të OSSH sh.a., si dhe çdo shoqërie të lidhur. Zyrtari duhet të ketë akses te zyrat e OSSH sh.a. pa njoftim paraprak;

4.1.4 të ketë akses tek të gjitha kontaktet e lidhura nga OSSH sh.a. me pjesëmarrësit e tjerë të tregut të energjisë elektrike, përdoruesit e rrjetit dhe palë të tjera të treta dhe te dokumentet origjinale (ofertat tregtare, deklaratat e pranimit, memorandumet, faturat etj.);

4.1.5 të marrë pjesë tek të gjitha takimet e organeve përkatëse të OSSH sh.a., përveç atyre të referuara në pikën 3.1.8., të cilat Zyrtari është i detyruar për t'i ndjekur;

4.1.6 të marrë pjesë, kur e shihet të nevojshme, në mbledhjet/takimet e organeve përkatëse, drejtuesve dhe punonjësve të OSSH sh.a., duke përfshirë dhe ato që kanë të bëjnë me aktivitetin e përditshëm të shoqërisë;

4.1.7 të japë opinionin e tij për dokumentet ose veprimet e brendshme të propozuara nga OSSH sh.a., në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me aktet ligjore në fuqi, përfshirë ndryshimet ligjore dhe rregullatore në fjalë, dhe me Programin.

4.2 Zyrtari gëzon edhe të drejta të tjera, të cilat nuk referohen në pikën 4.1, por vijnë si pasojë e detyrimeve të vendosura nga Ligji dhe/ose Programi, të lindura nga nevoja për kryerjen siç duhet të shërbimeve dhe përmbushjen e tyre sipas pëlqimit reciprok midis Palëve.

4.3 Palët duhet të sigurojnë, përmes bashkëpunimit reciprok, që të gjitha të drejtat e Zyrtarit janë plotësuar siç duhet në përputhje me objektivat e Programit.

5. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E OSSH sh.a.

5.1 Anëtarët e [organit/organeve përkatëse] dhe drejtuesit e përgjithshëm të OSSH sh.a. kanë të drejtën të kërkojnë nga Zyrtari të ofrojë shërbimet në kohën e duhur dhe sipas termave dhe kushteve të vendosur në Ligj, në Program dhe në këtë Kontratë.

5.2 Organet përgjegjëse të OSSH sh.a., të referuara në pikën 5.1, mund të kërkojnë në çdo kohë nga Zyrtari që të paraqesë shpjegime me shkrim ose raporte për sigurimin e shërbimeve dhe statusin e zbatimit të Programit.

5.3 OSSH sh.a., drejtuesit, punonjësit dhe/ose përfaqësuesit e tjerë të autorizuar, kanë të drejtën të

paraqesin kërkesat te Zyrtari, në lidhje me zbatimin në praktikë të Programit.

5.4 Udhëzimet, kërkesat ose çdo veprim tjetër i drejtuesit, punonjësit dhe/ose përfaqësuesit të autorizuar të OSSH sh.a. nuk duhet të jenë në konflikt me mandatin dhe/ose pavarësinë e Zyrtarit.

5.5 Për të siguruar kushtet e duhura për Zyrtarin për të kryer detyrat dhe përmbushur të drejtat e tij, sipas kësaj kontrate, OSSH sh.a. është e detyruar:

5.5.1 t'i ofrojë Zyrtarit një zyrë të kompletuar me të gjitha pajisjet tek ambientet e OSSH sh.a. dhe të sigurohet që ai të ketë të gjitha mjetet në zyrë (përfshirë kancelaritë, kompjuterin, pajisjet e komunikimit etj.), si dhe mbështetjen administrative të nevojshme për ofrimin e këtyre shërbimeve;

5.5.2 të paguajë Zyrtarin për shërbimet e ofruara nga ai, siç përcaktohet në pikën 6;

5.5.3 të udhëzojë drejtuesit dhe punonjësit për detyrimin që kanë për të bashkëpunuar me Zyrtarin, me qëllim zbatimin e Programit. Ky detyrim duhet të parashikohet qartë te kontratat dhe/ose udhëzimet për drejtuesit/punonjësit të kompanisë OSSH sh.a.;

5.5.4 t'i ofrojë Zyrtarit një akses të pakufizuar tek të gjitha të dhënat, kontaktet dhe zyrat e OSSH sh.a., si dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e tij;

5.5.5 të mbështesë Zyrtarin, duke ofruar të dhëna, informacion dhe asistencë në kohën e duhur;

5.5.6 të informojë Zyrtarin për mbledhjet/takimet e programuara ose jo të organeve përkatëse të OSSH, të drejtuesve dhe/ose punonjësve, dhe të ofrojë të gjitha materialet e nevojshme për të marrë pjesë në këto mbledhje/takime. Ky informacion dhe materialet duhet të ofrohen në kohë para takimit;

5.5.7 të përfshijë Zyrtarin në diskutime për planin afatgjatë për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, hartimin e akteve të brendshme dhe çështjeve të tjera funksionale, si dhe ndryshimet strukturore ose ato të shoqërisë;

5.5.8 të informojë Zyrtarin për ndonjë shkelje të pretenduar të Programit, konflikt ekzistues ose të mundshëm të interesit të drejtuesve dhe punonjësve të OSSH sh.a., shkelje të pretenduar të detyrimeve konfidenciale dhe çdo dukuri tjetër që



mund të ketë efekt në zbatimin e Programit të Përputhshmërisë.

5.6 Detyrimet e referuara në pikën 5.5 duhet të plotësohen nga administratori i OSSH sh.a., drejtuesit ose punonjësit, sipas kompetencave dhe mandatit të tyre. Çdo drejtues ose punonjës i OSSH sh.a. duhet të ketë të drejtën që t'i referohet Zyrtarit, në lidhje me zbatimin e Programit dhe është i detyruar të raportojë çdo shkelje të pretenduar.

5.7 Të drejtat dhe detyrimet e OSSH sh.a., të cilat nuk janë përmendur në pikën 5, por që rrjedhin nga Ligji dhe/ose Programi, me qëllim përmbushjen e shërbimeve në kohë nga Zyrtari, do të gjejnë zbatim sipas pëlqimit reciprok midis Palëve.

6. PAGESA PËR SHËRBIMET E ZYRTARIT

6.1 Pagesa për shërbimet e ofruara nga Zyrtari nuk duhet të bazohet tek vlerësimi i performancës nga drejtuesit e OSSH sh.a. Zyrtari duhet të paguhet sipas termave dhe kushteve të kësaj Kontrate.

6.2 Pagesa mujore për shërbimet e Zyrtarit do të jetë [•] lekë.

6.3 Pagesa e referuar në pikën 6.2 duhet të jetë pa taksat dhe zbritje të tjera. Nëse kërkohet që ato të vendosen sipas akteve ligjore në fuqi, tatimet, taksat dhe zbritjet, përfshirë ato që kanë lidhje me punësimin, duhet të kompensohen të ndara nga OSSH sh.a.

6.4 Të gjitha shpenzimet e nevojshme, të kryera në funksion të përmbushjes së detyrimeve sipas pikës 5, do të përballohen nga OSSH sh.a. dhe nuk do të kenë efekt të paga për shërbimet e ofruara nga Zyrtari.

7. DETYRIMET FINANCIARE DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

7.1 Palët janë të detyruara për zbatimin siç duhet të Kontratës, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në Ligji dhe tek Programi.

7.2 Në rast prishjeje të Kontratës, secila Palë mund të ankohet për humbjet direkte, të cilat duhet të kompensohen nga Pala fajtores. Këto humbje duhet të llogariten dhe arsyetohen sipas termave dhe kushteve të vendosur në aktet ligjore në fuqi.

7.3 Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga kjo Kontratë ose ato që kanë lidhje me zbatimin e saj duhet të zgjidhen me mirëkuptim dhe me konsultime reciproke mes Palëve.

7.4 Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet sipas përcaktimeve të pikës 7.3, secila Palë ka të drejtën që të drejtohet në ERE për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bazuar në procedurat e saj për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ose mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

7.5. Të dyja Palët bien dakord, që për qëllim të kësaj kontrate, duhet të përjashtohet gjykimi tregtar si formë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

8. VLEFSHMËRIA E KONTRATËS

8.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën kur ajo nënshkruhet nga Palët dhe mandati i Zyrtarit të fillon ditën tjetër të punës pas nënshkrimit.

8.2 Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e nënshkrimit.

8.3 Të gjitha ndryshimet e Kontratës duhet të bëhen sipas marrëveshjes reciproke mes Palëve, duke marrë parasysh, ndër të tjera, ndryshimet ligjore dhe ato të Programit. Çdo ndryshim në këtë kontratë duhet t'i nënshtrohet miratimit nga ERE, përndryshe nuk merr fuqi juridike.

8.4 Kjo kontratë mund të përfundojë para mbarimit të periudhës së vlefshmërisë së saj, siç specifikohet në pikën 8.2, vetëm në rastet e mëposhtme:

8.4.1 me kërkesën me shkrim të Zyrtarit, drejtuar Administratorit të OSSH sh.a. të paktën 2 (dy) muaj para datës së njoftuar për mbarimin e saj;

8.4.2 me nismën e OSSH sh.a. në rast se Zyrtari nuk zbaton përcaktimet e parashikuara në Ligji, te Programi dhe te kjo Kontratë;

8.4.3 bazuar në marrëveshjen reciproke midis Palëve.

8.5 Në rastin e marrëdhënieve të punësimit midis OSSH sh.a. dhe Zyrtarit, asnjë nga shkaqet dhe arsytet e lejuara nga Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë nuk mund të aplikohet për shkarkimin e Zyrtarit, përveç pikave të përmendura në pikën 8.4.

8.6 Para mbarimit të mandatit, qoftë për shkak të mbarimit të vlefshmërisë së Kontratës, ashtu edhe si pasojë e përfundimit para kohe, në përputhje me përcaktimet e pikës 8.4, Zyrtari duhet të përgatisë listën e dokumenteve në zotërim të tij, arsyetimet e nevojshme me shkrim dhe raportin përfundimtar të aktiviteteve të tij, të cilat do t'i dorëzohen Administratorit të OSSH sh.a.

8.7 Vendimi për përfundimin e kësaj Kontrate dhe, si pasojë, shkarkimi i Zyrtarit, duhet të merret



nga [organi përkatës] i OSSH sh.a. duke shpjeguar qartë arsyet për përfundimin e kontratës. Ky vendim duhet të miratohet nga ERE.

9. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

9.1 Kjo kontratë hartohet, interpretohet dhe zbatohet sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

9.2 Kontrata hartohet në gjuhën shqipe, në 3 (tri) kopje me fuqi të njëjtë ligjore, nga 1 (një) kopje për secilën prej Palëve dhe 1 (një) kopje duhet të paraqitet në ERE.

9.3 Kontratës i bashkëlidhet si pjesë integrale e saj shtojca 1, ku përfshihen kriteret përzgjedhëse të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.)

9.4 Me hyrjen në fuqi të kësaj Kontrate, Zyrtari depoziton në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë 1 (një) kopje të Kontratës dhe shtojcës së saj në gjuhën angleze.

10. KUSHTET E DOMOSDOSHME DHE NËNSHKRIMI NGA PALËT

10.1 Të gjitha komunikimet mes palëve duhet të zhvillohen duke u bazuar te kontaktet e mëposhtme dhe te kushtet e domosdoshme:

OSSH sh.a. [adresa] [numri i telefonit dhe adresa e email-it]	ZYRTARI I PAJTUESHMËRISË [adresa] [numri i telefonit dhe adresa e email-it]
Në emër të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.	Në emër të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë

Miratimi nga ERE

Vendimi i Bordit të ERE-s nr. __, datë __. __. 2022

SHTOJCA 1 KRITERET PËRZGJEDHËSE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH SHA)

Kriteret profesionale dhe kualifikuese të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë të OSSH sh.a. janë, si vijon:

- Të zotërojë një diplomë të nivelit “Master shkencor” ose ekuivalente në shkencat juridike/ekonomike /inxhinieri elektrike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në një nga këto degë.

- Të ketë përvojë pune prej të paktën 3 (tre) vjetësh në profesion nga të cilat të paktën 1 (një) vit në sektorin e energjisë elektrike.

- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

- Të jetë i padënuar më parë për kryerjen e një vepre penale.

- Të ketë aftësi të mira analizuese dhe komunikuese, si dhe aftësi për të pasqyruar dhe priorizuar një fushë të gjerë dhe të larmishme, sipas detyrave të parashikuara në Kontratën për ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë dhe Programin e Pajtuëshmërisë.

VENDIM

Nr. 344, datë 21.12.2022

MBI PEZULLIMIN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA PËR SHTYRJEN E AFATIT PROCEDURAL TË VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA NË AKTIVITETIN E OPERIMIT TË HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 59, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2094/4 prot., datë 19.12.2022, të drejtorive teknike të ERE-s, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. për shtyrjen e afatit procedural të vendimarrjes së Bordit të ERE-s për licencimin e saj në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.



- Në vijim, me vendimin nr. 13, datë 26.1.2022, Bordi ka vendosur:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrjen e afatit procedural të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri më datë 20.12.2022.

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të raportojë në ERE çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, mbi ecurinë e procesit për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

3. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.1.2022.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 13/2022 me shkresën nr. 130/1 prot., datë 28.1.2022.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 130/6 prot., datë 9.5.2022 dhe nr. 130/7 prot., datë 7.12.2022, shoqëria ka bërë me dije se në kuadër të plotësimit të dokumentacionit specifik për licencën e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror, po punon me intensitet për raportin final “WB20-ALB-ENE-01 Albania, Dumrea Underground Natural Gas Storage”, ndaj në këto kushte ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes finale për licencim në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri më 20.12.2023.

- Për sa informohet e depozitohet nga shoqëria, vlerësojmë se duhet sqaruar se raporti final “WB20-ALB-ENE-01 Albania, Dumrea Underground Natural Gas Storage”, nuk përmbush kërkesat apo dokumentacionin e paplotësuar ende nga kjo procedurë, pasi dokumentacioni i konstatuar si i munguar në këtë procedurë nuk përfshin vetëm dokumentacionin specifik, sipas tipit të licencës që mund të plotësohet nga raporti i përgatitur nga shoqëria, por edhe dokumentacion që lëshohet nga institucione/organe të tjera, siç është dokumentacioni pronësor, lejet dhe autorizimet mjedisore etj.

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet, se: nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”),

organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.

- Për gjithë sa më sipër parashtruar dhe për sa parashikohet nga KPA-ja, vlerësohet të pezullohet vendimmarrja e Bordit të ERE-s, në lidhje me licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror, deri në plotësimin e të gjithë dokumentacionit të munguar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrjen e afatit procedural të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror, deri në plotësimin e të gjithë dokumentacionit të munguar.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 345, datë 21.12.2022

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 171, DATË 16.8.2021, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR ‘ALBGAS’ SHA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 47, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe



procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2094/3 prot., datë 19.12.2022, të drejtorive teknike të ERE-s, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.8.2021, “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, ‘Albgaz’ sh.a.”, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 171, datë 16.8.2022, ka vendosur:

1. Të miratojë Programin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “Albgaz” sh.a., me kushtin që shoqëria, brenda 3 muajve ta depozitojë atë në ERE të përditësuar me përcaktimet, sipas kërkesave të pikës 5, pikës 6 dhe pikës 15, të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017.

2. Mosplotësimi i kushtit, sipas përcaktimeve të pikës 1, përbën shkak për rishikimin e këtij vendimi.

- Në vijim dhe bazuar te kërkesa e vetë shoqërisë “Albgaz” sh.a., Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 236, datë 26.11.202, vendosi:

Të zgjasë me 3 (tre) muaj, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, afatin e përcaktuar në pikën 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.8.2021, “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, ‘Albgaz’ sh.a.”

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme nëpërmjet shkresës nr. 53/9 prot., datë 2.11.2021, dhe nëpërmjet shkresës nr. 226 prot., datë 7.2.2022, i rikujtoi detyrimin për të plotësuar sa kërkohet brenda afateve të përcaktuara në vendim, pra brenda datës 26.2.2022.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 324 prot., datë 28.2.2022, është shprehur, se ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për të shtyrë afatin e plotësimit të kushteve të përcaktuara pikën 1 të vendimit nr. 171/2021, të ndryshuar.

- Në vijim, bazuar të diskutimet e zhvilluara në seancën dëgjimore të datës 11.4.2022, ora 11:00, pranë ambienteve të Entit Rregullator të Energjisë,

korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë “Albgaz” sh.a. dhe shqyrtimit të Programit të Përputhshmërisë në tërësi, vlerësohet që t’i lihet detyrë shoqërisë “Albgaz” sh.a. që të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për sa i përket:

a) marrëdhënieve të aksionarëve të shoqërisë “Albgaz” sh.a. me kompani të angazhuara me prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror dhe energji elektrike ose ato që kanë ndonjë interes komercial (pika 5 e Programit të Përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a.);

b) ndarjes dhe pavarësisë së organeve publike, të cilat janë të autorizuar të përfaqësojnë të drejtat e aksioneve shtetërore nga njëra anë dhe kompanive të angazhuara me prodhimin dhe furnizimin nga ana tjetër (pika 6 e Programit të Përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a.).

- Po ashtu, nga shqyrtimi në tërësi i Programit rezulton se janë pasqyruar drejtuesit e OST-së, sipas funksioneve që mbajnë, duke plotësuar kështu kërkesat e pikës 15 të Programit tip të Përputhshmërisë, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77/2017.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti administrativ, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.8.2021, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“1. Të miratojë Programin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, ‘Albgaz’ sh.a.”.

2. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.8.2021, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria ‘Albgaz’ sh.a. duhet të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për sa u përket:

a) marrëdhënieve të aksionarëve të shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. me kompani të angazhuara me prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror dhe energji elektrike, ose ato që kanë ndonjë interes



komercial (pika 5 e Programit të Përputhshmërisë së ‘Albgaz’ sh.a.);

b) ndarjes dhe pavarësisë së organeve publike, të cilat janë të autorizuar të përfaqësojnë të drejtat e aksioneve shtetërore nga njëra anë dhe kompanive të angazhuara me prodhimin dhe furnizimin nga ana tjetër (pika 6 e Programit të Përputhshmërisë së ‘Albgaz’ sh.a.).”.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 348, datë 28.12.2022

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË HEC “ARSTI” SHPK PËR
ZGJATJEN E AFATIT TË DEROGIMIT

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Kodi i Transmetimit” miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 186, datë 10.11.2017, “Kodi i rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018; “Kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 85, datë 12.5.2020, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, pasi u njoh me relacionin me nr. 2116/4 prot., datë 28.12.2022, të përgatitur nga

Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë HEC ‘Arsti’ sh.p.k., për zgjatjen e afatit të derogimit, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 185, datë 13.11.2020”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, ndër të tjera, me vendimin nr. 185, datë 13.11.2020, “Mbi shqyrtimin e kërkesës për derogim të shoqërisë HEC ‘Arsti’ sh.p.k.”, vendosi, si më poshtë vijon:

1. Të miratojë derogimin e kërkuar nga shoqëria HEC “Arsti” sh.p.k., në kushtet, si më poshtë vijon:

a) Objekti i derogimit: Realizimi i traktit 110 kV të linjës dhe trakti 110 kV të transformatorit ngritës që parashikohet të instalohet në nënstacionin 110/6.3 kV pranë HEC “Arsti” në dy faza implementimi.

b) Në fazën e parë parashikohet që trakti 110 kV të jetë i pajisur me thikë ndarëse për një periudhë 24-mujore dhe pas kësaj periudhe të pajiset me të gjithë elementet e nevojshme thikë dhe çelës.

c) Derogimin/pezullimin e përkohshëm të pikës 3(b) të nenit 35 të Kodit të Transmetimit. Kjo pikë, vetëm për këtë rast, do të jetë në zbatim të shkallëzuar me dy faza. Faza e parë, për një afat 24-mujor, trakti 110 kV, të jetë i pajisur me thikë ndarëse dhe në përfundim të këtij afati trakti 110 kV të pajiset me të gjitha elementet e nevojshme thikë dhe çelës.

d) Afati i derogimit për një periudhë 24 muaj.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 11.4.2022, ka miratuar “Kodin e Transmetimit”, i cili përbën tërësinë e rregullave që përcaktojnë në mënyrë të hollësishme normat që shërbejnë për të siguruar mbarëvajtjen e operimit dhe zhvillimit të sistemit të transmetimit, përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga OST ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, si dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet reciproke për OST-në dhe përdoruesit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe aktet e aplikueshme nga ENTSO-E.

- Shoqëria HEC “Arsti” sh.p.k., nëpërmjet shkresës nr. 75 prot., datë 7.11.2022, ka parashtruar kërkesën për zgjatjen e afatit të derogimit të miratuar me vendimin nr. 185, datë 13.11.2020. Kjo kërkesë është publikuar në faqen e internetit të ERE-s, në rubrikën “Konsultime”, më datë 9.11.2022, dhe nuk ka pasur asnjë koment nga



asnjë palë e interesuar mbi kërkesën e shoqërisë HEC “Arsti” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 85, datë 12.5.2020, ka miratuar kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 85, datë 31.5.2019, ka miratuar “Nivelet kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin a, b, “c” dhe “d”. Bazuar në këtë akt moduli gjenerues në fjalë kategorizohet si gjenerues i tipit “d” duke marrë në konsideratë një ndër kushtet, atë të lidhjes në rrjetin 110 kV. Gjithashtu, me vendimin nr. 129, datë 4.6.2018, ka miratuar Kodin e Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve.

- OST sh.a., lidhur me sa kërkohet nga ERE për opinion mbi zgjatjen e afatit të derogimit, nëpërmjet shkresës me nr. 6833/1, datë 23.11.2022, ka parashtruar ndër të tjera, se: “OST vlerëson se shtyrja e afatit të derogimit, i paraqitur për opinion nga ana juaj në OST nuk e cenon operimin dhe funksionimin normal të sistemit të transmetimit”.

- Rezulton se, shoqëria HEC “Arsti” sh.p.k., ka përmbushur fazën e parë të përcaktuar në derogimin e miratuar me vendimin nr. 185, datë 13.11.2020, e cila parashikon që trakti 110 kV të jetë i pajisur me thikë ndarëse.

- Vlerësojmë se kërkesa për zgjatje të një faze të derogimit nuk përbën një kërkesë të re, por kërkohet zgjatje të afati të kërkesës fillestare, për shkakë të cilat nuk varen dhe janë jashtë kontrollit të përdoruesit, si dhe është për një periudhë tranzitore prej 24 muajsh.

- Rezulton se gjatë periudhës së derogimit të miratuar me vendimin nr. 185, datë 13.11.2020, OST sh.a. dhe shoqëria HEC “Arsti” sh.p.k. nuk kanë raportuar asnjë problematikë me operimin në rrjet të këtij përdoruesi.

- Duke marrë në konsideratë kapacitetin e instaluar të këtij gjeneruesi (prej 3.130 mw) i lidhur në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike në raport me kapacitetet gjeneruese dhe ngarkesat e lidhura në të, vlerësojmë se nuk do ketë efekte negative në sigurinë e operimit dhe qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergetik, në kuptim të pikës I.1 të “Kritereve për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 85, datë 12.5.2020.

- Gjithashtu, edhe në parashtrimet e OST sh.a., e cila me shkresën me nr. 6833/1, datë 23.11.2022, ka konstatuar, se: “vlerëson se shtyrja e afatit të derogimit, i paraqitur për opinion nga ana juaj në OST, nuk e cenon operimin dhe funksionimin normal të sistemit të transmetimit”.

- Në këto rrethana, vlerësojmë se operatori OST sh.a. dhe shoqëria HEC “Arsti” sh.p.k., duhet të marrin masat e nevojshme teknike për të garantuar sigurinë e operimit të veprës dhe të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

- Paralelisht me këtë vendimmarrje nga ERE do të kryhen monitorime dhe inspektime për të kontrolluar ecurinë e punimeve për realizimin e objektit të derogimit, brenda periudhës 24- mujore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë HEC “Arsti” sh.p.k., për zgjatjen e fazës së dytë të derogimit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 185, datë 13.11.2020.

2. Objekti i derogimit: trakti 110 kV i linjës dhe trakti 110 kV i transformatorit ngritës në nënstacionin 110/6.3 kV pranë HEC “Arsti”, për një periudhë 24-mujore, të pajiset me të gjitha elementet e nevojshme, me çelësin e fuqisë.

3. Shoqëria HEC “Arsti” sh.p.k. të informojë periodikisht çdo 6 muaj në ERE mbi ecurinë e plotësimit të traktit 110 kV, me të gjitha elementet e nevojshme, përfshi dhe integrimin në sistemin SCADA.

4. Zgjatja e afatit të derogimit të vijojë për një periudhë prej 24 muajsh, duke filluar nga data 13.11.2022.

5. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë HEC “Arsti” sh.p.k., OST sh.a., dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,



brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 349, datë 28.12.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY TRADE” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2116/7 prot., datë 23.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Alb Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 283, datë 7.11.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 9.11.2022 dhe 10.11.2022), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe, në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.11.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1770/6 prot., datë 14.11.2022 dhe nr. 1840/4 prot., datë 17.11.2022, datë 6.12.2022, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit në mbledhjen e Bordit të datës 30.11.2022, të relacionit nr. 1999/4 prot., datë 24.11.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimeve, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nga Bordi u la detyrë që të sqarohet me shoqërinë e të dokumentohet se shoqëria disponon në fondet e saj vlerën përkatëse financiare, sipas parashikimeve të planit të biznesit.

- ERE, me shkresën nr. 1840/6 prot., datë 1.12.2022, i kërkoi shoqërisë të depozitojë sa më sipër citohet. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1840/7 prot., datë 6.12.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

- Me vendimin nr. 316, datë 9.12.2022, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me 20 (njëzet) ditë vendimmarrjen e tij mbi aplikimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k., duke i lënë shoqërisë detyrimin që brenda 10 (dhjetë) ditëve të depozitojë në ERE sqarimet përkatëse, në lidhje me dokumentacionin/mbështetjen financiare, që vendos në dispozicion të ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme me shkresën nr. 1840/8 prot., datë 15.12.2022. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1840/9 prot., datë 20.12.2022, dhe e-mail-in e protokolluar në ERE me nr. 1840/10 prot., datë 22.12.2022, ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.



- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar të gjithë dokumentacionin në zbatim të rregullores së licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 350, datë 28.12.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË KESH SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TEC I LUNDRUESHËM I INSTALUAR NË PORTIN E TRIPORTIT NË GJIRIN E VLORËS, ME FUQI TË INSTALUAR 110 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe neneve 4, pika 1, germa “a”, 5 pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.

109, datë 29.6.2016; dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 2116/10 prot., datë 23.12.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë KESH sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga TEC i lundrueshëm i instaluar në portin e Triportit në gjirin e Vlorës”,

konstatoi se:

- Shoqëria KESH sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 6552 prot., datë 20.12.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës, i përbërë nga dy gjenerues Tigri 1 dhe Tigri 3.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Aplikuesi, në zbatim të aneksit A, të rregullores së licencimit ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, por duke qenë se aplikimi i shoqërisë KESH sh.a. i referohet licencimit në prodhimin e energjisë elektrike nga dy centrale Tigri 1 dhe Tigri 3, shoqëria duhet të paguante një shumë më të madhe se ajo e depozituar për llogari të ERE-s.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria KESH sh.a. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 2.1, gjerat “b”, “e” dhe “f”. Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se mungon dokumentacioni, si vijon:



Neni 9, pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- germa “b”: Aplikanti duhet të përcjellë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti) për vetë shoqërinë KESH sh.a.

Pika 1.3 “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- germa “a”: Aplikanti duhet të përcjellë në ERE vërtetimin e detyrimeve tatimore dhe vërtetimin për sigurimet shoqërore e shëndetësore;

- germa “b”: Aplikanti duhet të përcjellë në ERE pasqyrat financiare për vitin 2021, si dhe të specifikojë sa është vlera totale e këtij investimi dhe se me cilat fonde do të mbulojë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike;

- germa “c”: Aplikanti duhet të përcjellë në ERE Programin Ekonomiko-Financiar të Korporatës.

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- germa “a”: Aplikanti duhet të përcjellë në ERE të dhënat teknike për këtë central, sipas shtojcës 2, në gjuhën shqipe;

- germa “b”: Shoqëria KESH sh.a. ka përcjellë në ERE edhe marrëveshjen përkatëse të qirasë të nënshkruar ndërmjet KESH sh.a. dhe shoqërive “Exelerate Global Operations” LLC dhe shoqërinë “Renco” SPA me nr. 1660/1 prot. i KESH sh.a, datë 04.04.2022, por kjo marrëveshje është në gjuhën angleze dhe në kuptim të nenit 8, pika 3, të rregullores, do t’i kërkohej shoqërisë ta depozitojë atë edhe në gjuhën shqipe;

- germa “c”: Aplikuesi ka përcjellë në ERE “Miratimin në parim për pikën e lidhjes së dy njësive gjeneruese termike lundruese me rrjetin e transmetimit në zonën e Vlorës, Bashkia Vlorë”, me nr. 6676/1 prot., datë 22.11.2022 të OST sh.a. Nëpërmjet këtij dokumenti, OST sh.a. shprehet se miraton në parim lidhjen me rrjetin e transmetimit të TEC-eve lundruese me fuqi të instaluar 130 mw. OST sh.a., në këtë miratim citon, se shoqëria KESH sh.a ka një afat kohor prej 18 muajsh për të konsideruar këtë ofertë dhe për të paraqitur kërkesën për lidhjen e marrëveshjes së lidhjes me OST sh.a., duke pasur në konsideratë kushtet dhe kërkesat teknike. Aplikanti duhet të përcjellë në ERE informacion në lidhje me ecurinë e procesit të pajisjes me nënshkrimin e Marrëveshjes respektive

dhe nëse e disponon, depozitimin e saj në ERE pa vonesë;

- germa “d”: Aplikuesi nuk ka përcjellë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor dhe në vijim vlerësohet t’i kërkohej, pasi sikurse rezultoi nga përmbajtja e deklaratës mjedisore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në përgjigje të kërkesës mbi aplikimin për VNM-në e thelluar të aplikantit KESH sh.a. me zhvillues projekti KESH sh.a. sqaron, se: Pas mbarimit të procedurave për VNM-në e thelluar, shoqëria “KESH” sh.a. duhet të aplikojë në portalin *online* të *e-Albania* “Aplikim për përdorim burim ujor” për t’u pajisur me leje bazuar në ligjin nr. 111/2012, “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 550, datë 15.7.2020. Aplikanti në vijim edhe të sa lënë detyrë nga AMBU-ja në Deklaratën Mjedisore, duhet të përcjellë në ERE informacion në lidhje me ecurinë e procesit të pajisjes me lejen e përdorimit të burimit ujor dhe nëse e disponon, depozitimin e saj në ERE pa vonesë.

Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të sa përcjellë në ERE nga shoqëria KESH sh.a., në zbatim të VKM-së nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, VKM-së nr.757, datë 21.12.2021, “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 22.10.2021, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin dhe parandalimin e saj”, si dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, si dhe faktit që ky TEC (i cili do të jetë në pronësi të KESH sh.a. si aset prodhues), pritet të fillojë punë në fillim të vitit 2023, për përballimin e situatës së emergjencës me furnizim me energji elektrike, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të



ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga dokumentacioni i aplikimit nga shoqëria rezulton, se TEC i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës, i përbërë nga dy gjenerues Tigr 1 dhe Tigr 3, do të shfrytëzohet për një periudhë 2-vjeçare, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënie e afatit maksimal për këtë licencë deri në 2 (dy) vjet.

- Nga ERE vlerësohet e nevojshme që përveç sqarimeve nëpërmjet korrespondencës shkresore të kryhen edhe seanca dëgjimore me shoqërinë KESH sh.a., në kuadër të sqarimit të plotë të të gjitha çështjeve, me qëllim plotësimin sa më të shpejtë të dokumentacionit për arsye të situatës së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë KESH sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës, me fuqi të instaluar 110 mw, për një afat 2-vjeçar (dyvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 351, datë 28.12.2022

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 213, SERIA PM13P, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 132, DATË 6.12.2011, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE- s DHE TRANSFERUAR ME VENDIMIN NR. 126, DATË 28.10.2013, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s TE SHOQËRIA “KURUM INTERNETIONAL” SHA, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-i “SHKOPET”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10 pika 3 dhe nenit 15, pika 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016; neneve 15 dhe 19 pika 1 germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2116/11 prot., datë 23.12.2022 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës shoqërisë “Kurum International” sh.a., për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s te shoqëria “Kurum International” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kurum International” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2093 prot., datë 16.12.2022, ka përcjellë kërkesën për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC “Shkopet”.

- Kërkesa për modifikim vjen për arsye se në maj 2023 kjo shoqëri ka programuar rehabilitimin e



HEC “Shkopet”, “optimizimi i operimit të turbinave”, gjatë të cilit do të zëvendësohen disa nga pajisjet kryesore të centralit dhe do të instalohen pajisje të reja dhe do të ketë një shtesë kapaciteti prej 4 mw dhe fuqia nominale do të jetë $P_n=28$ mw.

- Me vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 132/2011 “Për licencimin e shoqërisë ‘HEC Ulëz–Shkopet’ sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et Ulëz dhe Shkopet”, dhe nr. 136/2011, “Për licencimin e shoqërisë ‘HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2’ sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga ‘HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2’”, licencat që mbanin shoqëritë ‘HEC Ulez – Shkopet’ sh.p.k. dhe ‘HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2’ sh.p.k. janë transferuar te shoqëria “Kurum International” sh.a.

- HEC “Shkopet” është ndërtuar në vitin 1957 në lumin e Matit në qytetin e Burrelit – rrethi Dibër dhe me ligjin nr. 94/2013, datë 4.3.2013, “Për ratifikimin e kontratës së shitjes së 100% të aksioneve të shoqërisë “HEC Ulëz–Shkopet” sh.a. të lidhur ndërmjet METE-s (sot “MIE”) dhe shoqërisë “Kurum International” sh.a...”, është ratifikuar kontrata për shitjen e 100% të aksioneve nga shoqëria “HEC Ulëz–Shkopet” sh.a. te shoqëria “Kurum International” sh.a., duke kaluar “HEC Shkopet” në pronësi të “Kurum International” sh.a.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Kurum International” sh.a. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:

Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, germat “a”, “b” dhe “d”. Plotësuar.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se mungon dokumentacioni si vijon:

- Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4;

- germa “c”, shoqëria nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores.

- germa “e”, shoqëria duhet të depozitonte dokumentin përkatës mbi miratimin/qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes së Mjedisit në lidhje me kapacitetin e ri të kërkuar për modifikim prej 28 mw.

- germa “f”, shoqëria duhet të depozitonte miratimin/qëndrimin përkatës të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore në lidhje me kapacitetin e ri të kërkuar për modifikim prej 28 mw.

- germa “g”, shoqëria duhet të depozitonte në ERE qëndrimin/miratimin përkatës të Operatorit të Sistemit të Transmetimit në lidhje me kapacitetin e ri të kërkuar për modifikim prej 28 mw.

- Në kuadër të mosplotësimit nga Aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s tek shoqëria “Kurum International” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”, me kapacitet të instaluar 24 mw.

2. Nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime



materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 352, datë 28.12.2022

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË
10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘ALBGAZ’ SHA NË
AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË
GAZIT NATYROR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 2116/2 prot., datë 21.12.2022, të drejtorive teknike të ERE-s, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, ‘Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror’, i ndryshuar.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 14, datë 26.1.2022 ka vendosur:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar si më poshtë:

- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 21.12.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit.”

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të raportojë në ERE çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, mbi ecurinë e procesit në lidhje me plotësimin e kushteve të sipërcituara.

3. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.1.2022.

- ERE njoftoi shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës nr. 97/1 prot., datë 31.1.2022 dhe me shkresën e datës 97/2 prot., datë 4.4.2022, i kujtoi detyrimin për të raportuar në ERE mbi masat e marra nga ana e saj për të plotësuar kushtet e këtij vendimi.

- Në lidhje me kushtin që ka të bëjë me lejet dhe autorizimet mjedisore, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 130/2 prot., datë 21.2.2022, shoqëria ka depozituar VNM-në paraprake, datë 24.5.2021, për personin juridik “Albgaz” sh.a., për të zhvilluar projektin “Funksionimi i linjave të tubacioneve të gazit zona “Cakran (Drenovë)”, Ballsh, Ballsh, Fier dhe Ballsh-Usojë-Kash”, Bashkia Fier, Bashkia Mallakastër”.

- Me shkresën nr. 130/4 prot., datë 6.4.2022, ERE ka kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) informacion se me çfarë leje/autorizim mjedisor duhet të pajiset një shoqëri për të ushtruar, ndër të tjera, aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, ku ushtrimi i këtyre aktiviteteve kryhet me asetet përkatëse. Po ashtu, ERE ka kërkuar qëndrimin/interpretimin e AKM-së në lidhje me vlefshmërinë e vendimit për VNM paraprake, në të cilën përcaktohet se që ajo të jetë e vlefshme duhet të fillojë zbatimin në terren i projektit brenda dy vjetëve, ndërkohë që “Albgaz” sh.a. deklaroi se instalimet e tubacioneve janë ato ekzistuese dhe në zbatim të nenit 3, pika 10, të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, ky instalim trajtohet si një instalim i ri, ndaj dhe kjo VNM është e vlefshme.

- Me shkresën e saj nr. 2798/1 prot., datë 22.4.2022, protokolluar në ERE me nr. 130/5 prot., datë 26.4.2022, AKM-ja ka sjellë në vëmendje se shoqëria “Albgaz” sh.a. është pajisur me VNM si më sipër dhe ka bërë dije se: nëse projekti, që i është nënshkruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo te vendimit për VNM paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM fillon nga e para. Po ashtu, AKM-ja informon se VNM-së nuk është leje/licencë përfundimtare për zhvillimin e një projekti, por është një akt që lëshohet nga AKM-ja, i cili vendos kushte në funksion të mbrojtjes së mjedisit. Ky vendim është i vlefshëm nëse ndërtimi i objektit



është në përputhje të plotë me planet vendore të miratuara nga organet kompetente subjekti ka detyrim ligjor të zbatojë kushtet e vendimit për VNM paraprake, si dhe të marrë të gjitha lejet/licencat dhe miratimet përkatëse nga çdo institucion përkatës.

- Për sa informuar nga AKM-ja, pavarësisht se nuk ka shteruar të gjitha kërkesat për sqarim të ERE-s, nuk rezulton që të ketë ndonjë qëndrim të ndryshëm sa i përket pajisjes së shoqërisë “Albgaz” sh.a. me VNM paraprake përkatëse në kuadër të ushtrimit të aktiviteteve të saj.

- Me email-n e protokolluar në ERE me nr. 1902/2 prot., datë 19.12.2022, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka bërë me dije se sipas kushteve të vendosura në VNM-në paraprake për instalimet ekzistuese të linjave të tubacioneve aktive të transmetimit/shpërndarjes, nga ana e shoqërisë janë hartuar dhe dërguar pranë AKM-së raportet periodike të monitorimit, të cilat i ka vendosur dhe në dispozicion të ERE-s. Po ashtu, shoqëria shprehet se nga ana e AKM-së nuk ka pasur asnjë objeksion në lidhje me formën apo përmbajtjen e këtyre raportimeve, çka nënkupton pranimin në heshtje të tyre, siç parashikohet edhe në kushtet e VNM-së paraprake.

- Për gjithë sa më sipër, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar, dhe pikën 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, duke depozituar në ERE VNM paraprake përkatëse. Në çdo rrethanë, ky konstatim do të mbetet objekt rishikimi në rast se do të ketë një qëndrim të ndryshëm nga AKM-ja.

- Në lidhje me kushtin që ka të bëjë me certifikatën e sigurimit, shoqëria ka bërë me dije se në pamundësi për të përmbushur këtë detyrim gjatë vitit aktual 2022, ka parashikuar një fond të posaçëm në buxhetin e vitit 2023, duke plotësuar në këtë mënyrë dhe kushtet përkatëse të vendimit nr. 187/2017 dhe nr. 188/2017. Në këto rrethana, shoqëria ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për shtyrjen e afatit të plotësimit të plotësimit të këtij kushti deri më 20.12.2023.

- Në nenin 53, pika 3, të ligjit nr. 44.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi

publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”.

- Sa më sipër, rezulton se ky kusht nuk është përmbushur ende nga shoqëria, por duke marrë në konsideratë argumentin e saj se fondi përkatës për marrjen e kësaj certifikate është parashikuar në buxhetin e vitit 2023 dhe duke marrë parasysh afatet që mund të nevojiten për konsolidimin final të buxhetit, vlerësohet që afati për plotësimin e këtij kushti nga ana e shoqërisë të zgjatet deri më 30.4.2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar, si më poshtë:

1. “Të licencojë shoqërinë ‘Albgaz’ sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.4.2023, të depozitojë në ERE certifikatën e sigurimit.”

2. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 21.12.2022.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 353, datë 28.12.2022

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË
10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘ALBGAZ’ SHA NË
AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË
GAZIT NATYROR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 2116/2 prot., datë 21.12.2022, të drejtorive teknike të ERE-s, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, ‘Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror’, i ndryshuar.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin me vendimin nr. 15, datë 26.1.2022 ka vendosur:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, i ndryshuar si më poshtë:

- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 21.12.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit.”

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të raportojë në ERE çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, mbi ecurinë e procesit në lidhje me plotësimin e kushteve të sipërcituara.

3. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.1.2022.

- ERE njoftoi shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës nr. 97/1 prot., datë 31.1.2022 dhe me shkresën e datës 97/2 prot., datë 4.4.2022, i kujtoi detyrimin për të raportuar në ERE mbi masat e marra nga ana e saj për të plotësuar kushtet e këtij vendimi

- Në lidhje me kushtin që ka të bëjë me lejet dhe autorizimet mjedisore, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 130/2 prot., datë 21.2.2022, shoqëria ka depozituar VNM Paraprake, datë 24.5.2021, për personin juridik “Albgaz” sh.a., për të zhvilluar projektin “Funksionimi i linjave të tubacioneve të gazit zona “Cakran (Drenovë)–Ballsh, Ballsh, Fier dhe Ballsh–Usojë–Kash”, Bashkia Fier, Bashkia Mallakastër”.

- Me shkresën nr. 130/4 prot., datë 6.4.2022, ERE ka kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) informacion se me çfarë lejeje/autorizim mjedisor duhet të pajiset një shoqëri për të ushtruar, ndër të tjera, aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, ku ushtrimi i këtyre aktiviteteve kryhet me asetet përkatëse. Po ashtu, ERE ka kërkuar qëndrimin/interpretimin e AKM në lidhje me vlefshmërinë e vendimit për VNM paraprake, në të cilën përcaktohet se që ajo të jetë e vlefshme duhet të fillojë zbatimin në terren i projektit brenda dy vjetëve, ndërkohë që “Albgaz” sh.a. deklaroi se instalimet e tubacioneve janë ato ekzistuese dhe në zbatim të nenit 3, pika 10, të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ky instalim trajtohet si një instalim i ri, ndaj dhe kjo VNM është e vlefshme.

- Me shkresën e saj nr. 2798/1 prot., datë 22.4.2022, protokolluar në ERE me nr. 130/5 prot., datë 26.4.2022, AKM, ka sjellë në vëmendje se shoqëria “Albgaz” sh.a. është pajisur me VNM-në si më sipër dhe ka bërë dije, se: *nëse projekti, që i është nënshkruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.* Po ashtu, AKM-ja informon se VNM-së nuk është leje/licencë përfundimtare për zhvillimin e një projekti, por është një akt që lëshohet nga AKM-ja, i cili vendos kushte në funksion të mbrojtjes së mjedisit. Ky vendim është i vlefshëm nëse ndërtimi i objektit është në përputhje të plotë me planet vendore të miratuara nga organet kompetente. Subjekti ka detyrim ligjor të zbatojë kushtet e vendimit për VNM-në paraprake, si dhe të marrë të gjitha lejet/licencat dhe miratimet përkatëse nga çdo institucion përkatës.

- Për sa informuar nga AKM, pavarësisht se nuk ka shteruar të gjitha kërkesat për sqarim të ERE-s, nuk rezulton që të ketë ndonjë qëndrim të



ndryshëm sa i përket pajisjes së shoqërisë “Albgaz” sh.a. me VNM paraprake përkatëse në kuadër të ushtrimit të aktivisteve të saj.

- Me emaili-n e protokolluar në ERE me nr. 1902/2 prot., datë 19.12.2022, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka bërë me dije se sipas kushteve të vendosura në VNM-në paraprake për instalimet ekzistuese të linjave të tubacioneve aktive të transmetimit/shpërndarjes, nga ana e shoqërisë janë hartuar dhe dërguar pranë AKM-së raportet periodike të monitorimit, të cilat i ka vendosur dhe në dispozicion të ERE-s. Po ashtu, shoqëria shprehet se nga ana e AKM-së nuk ka pasur asnjë objeksion në lidhje me formën apo përmbajtjen e këtyre raportimeve, çka nënkupton pranimin në heshtje të tyre, siç parashikohet edhe në kushtet e VNM-së paraprake.

- Për gjithë sa më sipër, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1 të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar, dhe pikën 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, duke depozituar në ERE VNM paraprake përkatëse. Në çdo rrethanë, ky konstatim do të mbetet objekt rishikimi në rast se do të ketë një qëndrim të ndryshëm nga AKM-ja.

- Në lidhje me kushtin që ka të bëjë me certifikatën e sigurimit, shoqëria ka bërë me dije se në pamundësi për të përmbushur këtë detyrim gjatë vitit aktual 2022, ka parashikuar një fond të posaçëm në buxhetin e vitit 2023, duke plotësuar në këtë mënyrë dhe kushtet përkatëse të vendimit nr. 187/2017 dhe nr. 188/2017. Në këto rrethana shoqëria ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për shtyrjen e afatit të plotësimit të plotësimit të këtij kushti deri më 20.12.2023.

- Në nenin 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Sa më sipër, rezulton se ky kusht nuk është përmbushur ende nga shoqëria, por duke marrë në konsideratë argumentin e saj se fondi përkatës për marrjen e kësaj certifikate është parashikuar në buxhetin e vitit 2023 dhe duke marrë parasysh afatet që mund të nevojiten për konsolidimin final

të buxhetit, vlerësohet që afati për plotësimin e këtij kushti nga ana e shoqërisë të zgjatet deri më 30.4.2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 1 të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, i ndryshuar, si më poshtë:

1. “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.4.2023, të depozitojë në ERE certifikatën e sigurimit.”

2. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 21.12.2022.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 354, datë 28.12.2022

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 179, DATË
8.11.2017, “MBI CERTIFIKIMIN E
SHOQËRISË OPERATORI I
KOMBINUAR I GAZIT NATYROR
‘ALBGZ’ SHA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 37 dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 53, pika 2, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së



Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2116/1 prot., datë 21.12.2022, të drejtorive teknike të ERE-s, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ‘Albgaz’ sh.a.”, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 17, datë 26.1.2022, ka vendosur:

1. Të ndryshojë pikën 5.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

5.2 Shoqëria “Albgaz” sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE, brenda datës 20.11.2022, provat dokumentare për bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të dërgojë në ERE çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, informacion për përpjekjet konkrete të bëra në lidhje me realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor.

3. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.1.2022.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimin e mësipërm nëpërmjet shkresës nr. 85/2 prot., datë 28.1.2022.

- Me shkresën nr. 85/4 prot., datë 4.4.2022, drejtuar “Albgaz” sh.a., për dijeni Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ERE i ka kujtuar shoqërisë detyrimin për të raportuar në ERE mbi masat e marra nga ana e saj për të plotësuar kushtet e vendimit nr. 179/2017, të ndryshuar.

- Sa i përket kushtit të vendosur në pikën 5.1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179/2017, të ndryshuar, që lidhet me paraqitjen në ERE çdo vit ushtrimor të informacionit mbi pavarësinë e audituesve financiarë, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka paraqitur dokumentacionin respektiv dhe si i tillë ky kusht konsiderohet i plotësuar/përditësuar për

vitin 2021 dhe pika 5.1 e këtij vendimi mbetet e pandryshuar.

- Për kushtin e vendosur në pikën 5.2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179.2017, të ndryshuar, që lidhet me bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, nenet 11 dhe 46(10), të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Ekonomisë, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka bërë me dije se plotësimi i këtij kushti është përtej vullnetit të saj, por do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të adresuar pranë MIE-s gjetjen e një zgjidhjeje të gjithëpranuar brenda kuadrit ligjor. Po ashtu, shoqëria ka bërë me dije se po hedh hapa konkretë drejt një partneriteti të mundshëm me shoqëri të huaja (MoU me ENAGAS), të cilat kanë një përvojë të gjerë në sektorin e gazit natyror, çka do të sjellë dhe rikonfigurimin e përfaqësimit të kapitalit të shoqërisë. Në këto rrethana, shoqëria ka kërkuar shtyrjen shoqëria ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të këtij kushti deri në datën 20.11.2023.

- Duke qenë se ky kusht mbetet ende pa plotësuar për shkaqe që nuk varen nga vullneti i shoqërisë “Albgaz” sh.a., vlerësohet që të merret në konsideratë kërkesa e shoqërisë, sipas sqarimeve të dhëna nga ana e saj për shtyrjen e afatit të plotësimit të këtij kushti deri më 20.11.2023.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet, se: Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 5.2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, të ndryshuar, si vijon:

a) 5.2 Shoqëria “Albgaz” sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE brenda datës 20.11.2023 provat dokumentare për bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në



kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

2. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 21.11.2022.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 355, datë 28.12.2022

**MBI MIRATIMIN PARAPRAK TË
ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË
“ALBGAZ” SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 47, pika 2, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2116 prot., datë 21.12.2022, të drejtorive teknike të ERE-s, “Mbi miratimin paraparak të zyrtarit të përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a.”,

konstatoi se:

- Në nenin 47, pika 2, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, përcaktohet se: zyrtari i përputhshmërisë emërohet nga këshilli mbikëqyrës ose, nëse një organ i tillë nuk është formuar, nga organi kolektiv i menaxhimit të OST-së, pas miratimit paraparak nga ERE.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 78, datë 26.5.2017, është miratuar kontrata për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a., ndërsa me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 223, datë 16.10.2018, janë miratuar kriteret përzgjedhëse të zyrtarit të përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 223, datë 16.10.2018, është miratuar paraprakisht zyrtari i përputhshmërisë së OST-së së gazit natyror.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 565/8 prot., datë 20.11.2018, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka depozituar në ERE vendimin e Këshillit Mbikëqyrës së saj nr. 11, datë 30.10.2018, “Për emërimin e z. Elvis Ponari në detyrën e zyrtarit të përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a., si dhe kontratën për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë, nr. 78/1 prot., datë 13.11.2018, të nënshkruar mes “Albgaz” sh.a. dhe z. Elvis Ponari, e vlefshme për një periudhën prej 3 vjetësh, deri më 13.11.2021.

- Në vijim të mbarimit të mandatit të tij, ERE, me shkresën nr. 948/2 prot., datë 7.9.2022, ka kërkuar informacion nga “Albgaz” sh.a., mbi arsyet pse nuk është depozituar ende për miratim emri i zyrtarit të përputhshmërisë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1902 prot., datë 3.11.2022, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për miratimin paraparak të zyrtarit të përputhshmërisë, z. Elvis Ponari, duke bërë me dije se kjo kandidaturë është përzgjedhur pas një procesi paraparak, ku është verifikuar dhe përmbushja e kriterëve nga ana e tij.

- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 47, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, vlerësohet miratimi paraparak i z. Elvis Ponari si zyrtar i përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a.

- Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ky miratim, “Albgaz” sh.a. duhet të depozitojë në ERE vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “Albgaz” sh.a., për emërimin e z. Elvis Ponari si dhe kontratën e nënshkruar prej tij dhe “Albgaz” sh.a.

- Në raportin vjetor të përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a. për vitin 2021, duhet të përfshihet dhe raportimi për periudhën 14.11.2021–31.12.2021.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të miratojë paraprakisht z. Elvis Ponari si zyrtar të përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a.

2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ky miratim, shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të depozitojë në ERE:

a) vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “Albgaz” sh.a., për emërimin e z. Elvis Ponari;

b) kontratën për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë të nënshkruar mes “Albgaz” sh.a. dhe z. Elvis Ponari.

3. Në raportin vjetor të përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a. për vitin 2021, zyrtari i përputhshmërisë duhet të përfshijë dhe raportimin për periudhën 14.11.2021–31.12.2021.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtorja e Gazit Natyror, të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., z. Elvis Ponari dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 358, datë 30.12.2022

**MBI ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJES NDËRMJET
SHOQËRISË “KROI MBRET ENERGJI”
SHPK DHE SHOQËRISË FURNIZUESI I
TREGUT TË LIRË SHA DHE
SHOQËRISË OPERATORI I SISTEMIT
TË SHPËRNDARJES SHA**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, germet “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrik”; VKM nr. 650, datë 10.10.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 584 datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar; si dhe nenit 23, pika 12, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 3.9.2016; Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016 dhe “Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016, ndryshuar me vendimin nr. 147 datë 30.9.2016, ndryshuar me vendimin nr. 255 datë 24.12.2018; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës me nr. 2129/3 prot., datë 29.12.2022, “Mbi kërkesën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. dhe Shoqërisë Furnizuesi i Tregut të lirë sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 113, datë 19.05.2022, “Mbi kërkesën për zgjidhjen e



mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. dhe shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., vendosi:

Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. dhe Shoqërisë “FTL” sh.a. dhe OSSH sh.a., duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me rregulloren “Për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

- Rezulton se gjatë seancave dëgjimore të zhvilluara në datat 5.4.2022 dhe 15.4.2022 dhe shqyrtimit të mosmarrëveshjes, palët parashtruan qëndrimet dhe argumentet e tyre duke u fokusuar kryesisht në qëndrimet/prendimet si më poshtë vijon:

i) nga shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., pretendohet: kompensimi i energjisë referuar sasisë në kWh të prodhuar dhe çmimeve të miratuara nga ERE për prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet Backa 1 A dhe C për periudhën nga data 15.11.2019–30.4.2021, ku rezulton energji elektrike e prodhuar në vlerën prej 130.763.110 lekë;

ii) nga shoqëria “FTL” sh.a., pretendohet: se nuk ka asnjë dokumentacion provues përkatës dhe respektivisht për periudhën e pretenduar nga shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., nuk ka pasur një marrëveshje shit-blerjeje energjie respektivisht: Kontrata për shit-blerje të energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.06.2016, e ndryshuar;

iii) shoqëria “OSSH” sh.a., (në mënyrë të përmbledhur), parashtron: Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., nuk ka zbatuar detyrimet e Kodit të Shpërndarjes, rregullores së lidhjeve të reja dhe rregullores së shfrytëzimit teknik, sipas të cilave specifikohet mënyra e operimit të centralit në rrjetin e shpërndarjes. Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., ka aplikuar për lidhje të re në rrjetin e shpërndarjes për burimin gjenerues HEC Backa me shkresën nr. 5612 prot., data 25.4.2018.

Për sa i përket energjizimit të HEC Backa 1, A, C, OSSH sh.a., në datën 6.11.2019 ka urdhëruar vënien në tension të HEC për qëllime testimi me ngarkesë, për një periudhë 72 orë, nga data 8.11.2019–12.11.2019 kur është njoftuar përfundimi i provës 72-orëshe të HEC Backa dhe janë shkëputur nga rrjeti i shpërndarjes në datë 15.11.2019

- Në mbështetje të neneve 13 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 26, pika 1, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, me urdhrin nr. 38 prot., datë 29.3.2022 dhe urdhrin nr. 88 prot., datë 6.6.2022 është ngritur dhe zgjeruar grupi i punës për zgjidhjen dhe shqyrtimin e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “FTL” sh.a., dhe shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k.

- OSHEE sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 5612/5 prot. datë 25.06.2018 ka dhënë miratimin e pikës së lidhjes për kaskadën e HEC-eve Backa 1, Backa 2, Backa A, Backa B, Backa C, për shoqërinë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. ku ndër të tjera përcaktohet se: kaskada e HEC-eve Backa 1, Backa 2, Backa A, Backa B, Backa C do të lidhet me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet zbarave 10 kV të nënstacionit 35/10 kV Çorovodë e Re. Si dhe matja e energjisë elektrike do të realizohet me matës statik me dy drejtime (marrje–dhënie) për energjinë aktive dhe reaktive sipas kërkesave të Kodit të Matjes.

- Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. nëpërmjet shkresës me nr. 23 prot., datë 30.10.2019, drejtuar Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH) sh.a. parashtron se: duke qenë se punimet për ndërtimin e këtyre HEC-eve kane përfunduar, po paraqesim te ju kërkesën për energjizim të linjës si dhe kërkesën për lidhje kontrate shitblerje të energjisë elektrike me shoqërinë OSHEE sh.a.

- Nëpërmjet procesverbalit montim sistemi matje ndërmjet palëve OSHEE sh.a. dhe shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., datë 15.11. 2019, procesverbal ndërmjet shitësit PPE shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. dhe OSHEE sh.a. Blerësi. Procesverbali është nënshkruar nga përfaqësuesit e dy palëve si të shoqërisë OSHEE sh.a. dhe shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., i cili evidenton gjithë elementet e sigurisë së kërkuar



ku përfshihen; fuqia e instaluar, pika e livrimit, pika e matjes, skema e lidhjes, të dhëna për sistemin e matjes, tipi i matësit, viti i prodhimit, koeficienti i leximit, vulat përkatëse me numrat serial të OSHEE sh.a., si dhe element të tjerë që tregojnë të dhëna të sistemit të matjes. Në këtë procesverbal evidentohet edhe energjia e prodhuar dhe energjia e konsumuar.

- Gjithashtu rezulton se palët FTL sh.a./OSHEE Group sh.a., dhe shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., më datë 30.4.2021, kanë nënshkruar procesverbalin “Procesverbal montim sistemi matje”, ndërmjet shitësit PPE shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. dhe FTL sh.a./OSHEE Group sh.a., Blerësi. Procesverbali i nënshkruar evidenton gjithë elementet e sigurisë së kërkuar ku përfshihen; Fuqia e instaluar, pika e livrimit, pika e matjes, skema e lidhjes, të dhëna për sistemin e matjes, tipi i matësit, viti i prodhimit, koeficienti i leximit, vulat përkatëse me numrat serial të OSHEE sh.a., si dhe elemente të tjera që tregojnë të dhëna të sistemit të matjes. Në këtë procesverbal ndër të tjera evidentohet: energjia e prodhuar dhe energjia e konsumuar.

- Rezulton se, ERE nëpërmjet shkresës nr. 697/1 prot., datë 3.6.2021 ka bërë me dije se: i) palët kanë pranuar me veprime konkludente kontratën si veprim juridik, nëpërmjet shprehjes së vullnetit të tyre bazuar dhe në nenin 80 të Kodit Civil, i cili parashikon se; veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit, i cili sipas arsytimit të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë me **nr. 11243-01443-00-2008 i Regj. Themeltar nr. 00-2013-763 i vendimit (172)**, ku parashikohet se: ...me shprehjen “shfaqje tjetër e padyshimtë e vullnetit”, do të kuptojmë pikërisht, shfaqjen e vullnetit me veprime konkludente ose me heshtje. Një gjë e tillë parashikohet qartë dhe në nenet 669 dhe 676 të Kodit Civil, të cilat nuk bëjnë gjë tjetër, veçse plotësojnë kuptimin e nenit 80 të K.Civil.”; ii) ...fakti që Operator i sistemit të shpërndarjes ka vijuar pranimin në rrjet të energjisë elektrike, tregon qartë që ajo ka pranuar këtë propozim dhe ka qenë dakord me vazhdimin e këtij bashkëpunimi, me kushtet e mësipërme, në të kundërt do të kishte ndërprerë kryerjen e shërbimeve, iii) ...Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. duhet të marrë masat për rakordimin dhe njohjen e kompensimit të energjisë

elektrike të prodhuar nga ana e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. nëpërmjet HEC-ve Backa 1, A dhe C në bazë të legjislacionit në fuqi.

- Veç sa më sipër lidhur me pretendimet e shprehura nga shoqëria OSSH sh.a. mbi shoqërinë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., duke qenë se jemi në rastin e mosmarrëveshjes ndërmjet Përdoruesit të rrjetit të shpërndarjes respektivisht shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k me operatorin e OSSH sh.a. ka një mospërputhje të lindur në kushtet e periudhës së emergjencës COVID-19. Konstatojmë se periudha në të cilën kjo situatë ka ndodhur rezulton dhe në kushtet e pandemisë COVID-19.

- **Rezulton se ndikimi kryesor i pandemisë tek operatorët e rrjetit të vendeve të EU** sikurse ka raportuar CEER (Këshilli Evropian i Rregullatorëve të Energjisë) më 8 shkurt 2022 në analizën e bërë për efektet e pandemisë COVID-19 mbi sektorin e energjisë për periudhën janar 2020–qershor 2021, pasi qeveritë filluan të vendosin masa për të frenuar përhapjen e COVID-19, operatorët e rrjetit të EU morën masa mbrojtëse shëndetësore në përputhje me udhëzimet e qeverisë ku përcaktuan se cilat detyra do të kishin prioritet duke u fokusuar tek aktivitetet që mund të shtyhen dhe kjo bëri ndarjen e stafit operacional nga pjesa tjetër e fuqisë punëtore për të siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve thelbësore.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 96, datë 27.10.2014, ka vendosur për licencimin e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHE) sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike, në të njëjtën kohë bordi i ERE-s me vendimin nr. 216, datë 11.10.2018, ka vendosur transferimin e licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14Sh, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, të shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.).

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 198, datë 3.9.2018 mori vendim për licencimin e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar.

- Rezulton se shoqëria FTL sh.a. në datën 30.4.2021 ka montuar dhe vulosur të njëjtin sistem



matje me atë të realizuar nga shoqëria OSHEE sh.a. në datën 15.11.2019, pasi të gjithë elementët matësi, transformatorët e rrymës dhe të tensionit janë të njëjtë.

- Ky element ka ndikuar në faktin e evidentimit të sasisë së prodhuar nga shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., para datës 30.4.2021, kur është nënshkruar edhe kontrata e shit-blerjes së energjisë elektrike ndërmjet palëve. Pranimi i të njëjtit sistem matje dhe nga FTL sh.a. sikurse evidentuar në procesverbalet e mbajtura më datë 15.11.2019 dhe datë 30.4.2021 është një argument që nuk mbështet sa pretenduar nga FTL sh.a. me shkresën nr. 1413/1 prot., datë 9.6.2022 të sipërcituar.

- Nëse shoqëritë FTL sh.a. dhe OSSH sh.a. kanë konstatuar se shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., po operonte pa përmbushur kushtet e licencës së dhënë nga ERE, do të duhej të kishin bërë me dije që në momentin që evidentohet ky fakt në mënyrë që ERE të mund të ndërhynte dhe të merrte masat përkatëse. Kushti i licencës sikurse dhe vet FTL sh.a. bën me dije nëpërmjet shkresës nr. 1413/1 prot., datë 9.6.2022 është shfuqizuar me vendimin nr. 95, datë 6.4.2021 të Bordit të ERE dhe evidentimi i këtij fakti pas shfuqizimit të këtij kushti e bën të pamundur ndërhyrjen e ERE kur kushti nuk ekziston.

- Në çdo rast nëse shoqëritë prodhuese përfshi dhe shoqërinë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., nuk operojnë në zbatim të kushteve të licencës përbën një shkelje të këtyre kushteve dhe i ngarkon me përgjegjësi këto shoqëri, operatorët e rrjetit dhe FTL sh.a. të cilët kërkojnë depozitim të licencës nga shoqëritë prodhuese për të vijuar marrëdhëniet kontraktore duhet të njoftojnë në kohë ERE për çdo problematikë të ndeshur, që t'i krijojnë mundësi ERE të ndërhyjë me masat respektive.

- Në këto rrethana duhet marrë në konsideratë fakti se energjia elektrike është një produkt i cili prodhohet, livrohët dhe konsumohet në kohë reale. Sikurse evidentohet dhe nëpërmjet shkresës së OSHEE sh.a. nr. 5612/5 prot. datë 25.6.2018 u është dhënë miratim pike lidhje kaskadës së Heceve Backa 1, Backa 2, Backa A, Backa B, Backa C, në rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet zbarave 10 kV të nëstacionit 35/10 kV Çorovodë e Re, si dhe matja e energjisë elektrike do të realizohet me matës statik me dy drejtime (marrje - dhënie) për energjinë aktive dhe reaktive sipas kërkesave të kodit të matjes. Për rrjedhojë prodhimi i realizuar dhe që

aktualisht realizohet nga kjo shoqëri livrohët në rrjetin e shpërndarjes.

- Bazuar në VKM-në nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, neni 11 pika 3 përcakton se: (vendim i cili ka qënë në fuqi atë periudhë kohore).

Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, deri në krijimin e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme dhe krijimin e tregut të ditës në avancë, do ta tregtojë këtë energji për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes me të njëjtin çmim me të cilin e blen këtë energji nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, deri në përfundimin e kontratave të shitblerjes së energjisë. Në rast të tepricave të krijuara ato do të tregtohen në treg të parregulluar me çmimin që ofron ky treg në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara, bazuar në rregulloren për tregtimin e energjisë elektrike, që miratohet me vendim të Entit Rregullator të Energjisë.

- Aktualisht VKM nr. 244, datë 30.3.2016, e ndryshuar është shfuqizuar me VKM-në nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” ku ndër të tjera përcakton si më poshtë vijon:

1. Çdo detyrim i vendosur ndaj të licencuarve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në lidhje me burimet e rinovueshme të energjisë, do të konsiderohet detyrim i shërbimit publik.

2. Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE. Shoqëria publike e prodhimit ka të drejtë të lidhë kontratë blerjeje të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme që shërbejnë për diversifikimin e prodhimit e saj.

3. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, deri në krijimin e operatorit të energjisë së rinovueshme dhe krijimin e tregut të ditës në



avancë, do ta tregtojë këtë energji për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, me të njëjtin çmim me të cilin e blen këtë energji nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, deri në përfundimin e kontratave të shitblerjes së energjisë.

- VKM nr. 456, datë 29.6.2022 sipërcituar ka të njëjtat detyrime ligjore për shoqërinë FTL sh.a. lidhur me energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme ku përfshihen dhe burimet e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k.

- Energjia e prodhuar nga Hec-et e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., e livruar në rrjetin e shpërndarjes dhe për të cilën nuk evidentohen transaksione me furnizues të tjerë të energjisë elektrike për periudhën 15.11.2019–30.4.2021, ka shkuar për nevojë të përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik.

- Për sa parashtruar më lart vlerësojmë se shoqëritë FTL sh.a. dhe “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. duhet të marrin masa për të rakorduar ndërmjet tyre sasinë e energjisë elektrike të evidentuar në matës për periudhën 15.11.2019–30.4.2021, duke marrë në konsideratë procesverbalet përkatëse të instalimit të sistemit të matjes evidentuar më sipër. Gjithashtu shoqëria duhet të rakordojë bilancin energjetik me OSSH sh.a. për këtë sasi energjie në përputhje me përcaktimin e mësipërm të VKM-së nr. 456/2022.

- Vlerësojmë se, mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 43/2015, për sa parashikohet në lidhje me kërkesat për energji elektrike, mënyra dhe masat e plotësimit të saj përcaktohen në Bilancin vjetor të energjisë dhe në kërkesën afatgjatë për energji elektrike që miratohen dhe publikohen nga Rregullatori si dhe, faktin se operatorët e sistemit energjetik ofrojnë të dhëna për prodhimin bruto dhe neto të energjisë elektrike, kapacitetin e instaluar të centraleve, importin eksportin, energjinë elektrike të furnizuar, humbjet në transmetim dhe shpërndarjen, të dhëna lidhur me nënstacionet, të dhëna lidhur me gjatësinë dhe nivelin e tensioneve të linjave, linjat e reja dhe të planifikuara si dhe të dhënat e tjera relevante.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shoqëritë OSSH sh.a., dhe Kroi Mbret Energji sh.p.k., të marrin masa për të evidentuar sasinë e energjisë elektrike në matës për periudhën 15.11.2019–30.4.2021, shoqëritë FTL sh.a. dhe “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. të marrin masa për të rakorduar ndërmjet tyre sasinë e energjisë elektrike për periudhën 15.11.2019–30.4.2021.

2. Shoqëria FTL sh.a. të realizojë rakordimet përkatëse në bilancin energjetik me shoqërinë OSSH sh.a. për këtë sasi të energjisë elektrike.

3. Shoqëria FTL sh.a. të njohë dhe të paguajë shoqërinë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. për sasinë e energjisë elektrike të rakorduar dhe të evidentuar në sistemin matës sipas çmimit të miratuar nga ERE për periudhën përkatëse 2019–2021.

4. Në asnjë rast shoqëria OSSH sh.a., nuk do të lejojë lidhjen në rrjetin e shpërndarjes dhe shoqëria FTL sh.a., nuk do të lejojë lidhjen e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike për vendimet e licencimit të dhëna nga ERE përpara operimit të veprës në sistemin energjetik.

5. Ky vendim vlen vetëm për këtë rast të shqyrtuar.

6. Brenda 5 ditëve nga marrja dijeni palët të njoftojnë zyrtarisht ERE për zbatimin e vendimit.

7. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë FTL sh.a., OSSH sh.a. dhe “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë